SHOQËRIA KULTURORE ARTISTIKE
„ SHARRI “
HANI I ELEZIT
(Monografi në 40 vjetorin e aktivitetit)

Hani i Elezit
2014

Shaban Çupi:
Shoqëria Kulturore Artistike ,, Sharri”
Hani i Elezit
(Monografi në 40 vjetorin e aktivitetit)

Botues:
Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë e Sportit
Hani i Elezit
Redaktor: Nuriman Kuka
Recensent: Nejazi Dernjani
Lektor e korrektor : Akif Shkreta
Piktura në ballinë: Aman Kuka

Viti i botimit: 2014

Pamje nga një pjesë e Hanit të Elezit në vitin 1968[1]



Fabrika e çimentos e vitit 1973

[1] Fotografi e marrur nga Rexhep Shkreta, botohet për herë të parë

Gjurmëve të vlerave etnomuzikologjike në trevën e Hanit të Elezit

Gjatë shekujve, treva e Hanit të Elezit ka kultivuar dhe përcjellë te gjeneratat e më pasme, një traditë të pasur të vlerave të trashëgimisë sonë kulturore duke përfshirë ato arkeologjike, arkitekturale, etnologjike e në këtë rast edhe muzikore.

Banorët e kësaj treve, rritur e plakur nën pushtime të huaja, janë munduar të kenë një sistem të veçantë të jetës së tyre, sistem ky, jashtë rrethojës ligjore të pushtuesve. Ata, duke mos hequr dorë nga përkatësia e tyre ilire-arbërore-shqiptare, me të vetmen armë që kishin, pra gjuhën e bukur shqipe, thurën këngë e ngritën valle, ku herë fshehur e herë hapur, ruanin, kultivonin dhe përcjellin tek brezat e rinj prushin e etnosit shqiptarë e bashkë me atë, një trashëgimi të gjithanshme nga e kaluara jonë.

Të parët tanë me lahutat, çiftelitë, defat, kavallet dhe fyejt që i gdhendnin vetë, aty në mes të odave tona, të rrethuar për rreth me plisbardhë e të veshur në tirq e xhurdi, këndonin këngën e jetës e cila për shqiptarin çdo herë ishte e rëndë. Këndonin edhe këngë arshikie, por s`harronin të këndonin edhe për ata që ranë për këtë copë dheu të cilin ua kishte ndarë Zoti i gjithësisë.

Me këngët që ishin përcjellë, siç thuhet nga goja në gojë, këndonin këngën e Avdi Hysës vrarë nga cubat e Cetinjes, këndonin dhe mallkonin Novicën e zi i cili shkrumboi familjen e Demë Ahmetit në Llap, këngën e Hasimes, Hasan Agës, por s`harroheshin as këngët e nizamëve që të thernin shpirtin, sidomos këngën e Arif Sinanit dhe sinanëve të tjerë që vitet i kalonin në dhe të huaj me mallin dhe djegën e familjes e të shtëpisë.

Çdo kohë ka artistët e vet; këngëtarët, valltarët, humoristët dhe instrumentalistët. Dallojnë vetëm rrethanat kur jetuan dhe vepruan ata. Në hulumtim të trashëgimisë sonë kulturore,

mësojmë se këngët, vallet dhe lojërat e ndryshme, qoftë nga burrat, qoftë nga gratë, nuk kanë munguar në asnjë kohë.

Stina e verës, banorët e kësaj treve i shpërndante fushave për sigurimin e kafshatës së bukës së kallamojtë, por kur bëhej ndonjë dasmë, gëzoheshin siç thuhej edhe trarët e shtëpisë. Në dasmë merrnin pjesë i madh e i vogël ku edhe këndonin e vallëzonin këngët dhe vallet më të bukura. Gëzoheshin burrat, gëzoheshin gratë e kënaqeshin fëmijët. Defatoret thurnin këngët më të bukura për nusen e cila do ta zbukuronte dhe shtonte shtëpinë, ndërsa burrat djersitnin daullegjinë me vallet e tyre.

Kujtesa popullore e trevës sonë, mban mend këngëtarë e valltarë të dalluar të cilët artin e tyre nuk kishin ku ta shprehnin pos në dasma, në oda dhe gazmende familjare. Por, kur bora mbulonte shtigjet, atëherë netët e gjata të dimrit i kalonin në këngë, lojra e humore therëse ku siç thuhet ,,shkyheshin " brinjët nga të qeshurat dhe në këtë mënyrë sfidonin të keqen që pushtuesit e mbjellnin kudo.

Në fshatin Seçishtë, duke u thelluar në të kaluarën e largët, dalloheshin: Hisni Luri, Kadri Luri, Mexhit Shkreta, Mendu Kuka, Hamdi Shkreta, Xhemal Shkreta, Qamil Kalisi, Afet Kalisi, Adem Shkreta, Muharrem Shkreta e Nuhi Greçani[2], të cilët me këngët, vallet dhe me zërin e bukur të kavajve, argëtonin bashkëvendasët e tyre, ndërsa në fshatin Kryenik dalloheshin: Neshat Qajani, Azem Thaçi, Sulejman Thaçi e Sefer Thaçi[3]. Në fshatin Dimcë[4] Hamit Suma, Shahin Tuçi e Fari Tuçi, në rënie të kavajve, ndërsa Imer Tuçi, valltar. Në fshatin Guranë, shquheshin

[2] Informatë nga Rexhep Shkreta e Xhevat Shkreta si dhe Elham Kalisi dhënë autorit më 19.12.2013 dhe me 20.12.2013
[3] Informatë nga Fejzullah Krasniqi dhënë autorit më 20.12.2013
[4] Informatë nga Sahit Shiti dhënë autorit më 6.1.2014

Shaqir Kaloshi, Sali Berisha, Hetem Berisha, Shefki Vila e Osman Kaloshi[5].Në fshatin Paldenicë shquhej Hebib Dernjani, më këngën e Zhutës, Tefik Dernjani me këngë majekrahu, në lodra kërcenin Abedin Vila e Faik Dernjani[6], ndërsa kur vinte për muhabet te bija e tij në fshatin Paldenicë, Bajram Tanusha[7], mblidhej i tërë katundi dhe kujtesa popullore mban mend vetëm pak vargje të një kënge të moçme të bajraktarëve dhe bajraqeve në hapësirën shqiptare:

Bajraqet po hiqen
Si kandil po digjem...[8]

Kujtohen edhe pak vargje të një kënge tjetër mbi njëqind vjeçare, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ku shqiptarët të detyruar për të shkuar nizam në dhëna të huaja, larg shtëpisë, gruas e fëmijëve, i këndonin gjendjes së re të krijuar, dhe kënga thotë:

Lumetna për mretin[9] *tonë*
Se asker nuk po na qon...

Gjithashtu, krahas artdashësve të tjera, në fshatin Puset e Nikës, shquheshin me këngë: Nazmi, Hasip e Rufat Brava, në rënie të kavajve: Qerim Brava e Selim Brava; në valle, Sim Daci, Adem Daci e Zemri Daci[10], ndërsa në humor Halim Ballazhi edhe tani, kurse Ahmet Brava, si pjesëmarrës i LDB-së në Shqipëri, nga fshatrat e asaj ane të atdheut, kishte sjellë një buqetë këngësh në Puse të Nikës, të cilat me ëndje i këndonte jo vetëm ai, por edhe bashkëfshatarët e tij të cilët mbanin ison.

---

[5] Informatë nga Sherif Berisha, Miqail Vila e Faruk Berisha dhënë autorit më 8.1.2014
[6] Informatë nga Sefer Çupi, dhënë autorit më 10.1.2014, Paldenicë
[7] Bajram Hyseni nga Tanusha, përndryshe babagjyshi i autorit të kësaj monografie, pjesëmarrës i luftës në Karadak të Shkupit në vitin 1944.
[8] Informatë nga Sefer Çupi, Paldenicë, 22.12.2013
[9] Ismail Qemali
[10] Informatë nga Nuri Brava, Puset e Nikës dhënë autorit më 13 .1.2014

Në fshatin Dërmjak, kujtohen si artdashës Mustafë Curri në rënie të kavajve, Nevzat Curri edhe të kavajve edhe të valleve si dhe Bajrush Curri në rënie të fyellit[11].

Në fshatin Rezhancë, këngët e Mujës dhe Halilit si dhe këngë të tjera, madje edhe me çifteli, i ka kënduar Halil Rogaçi ish i burgosur politik nga viti 1948, ndërsa kavajve u kanë rënë vëllezërit e tij, Bexheti dhe Beqiri[12].

Kur viteve të 50-ta të shekullit XX, në fshatin Paldenicë erdhën për të kënduar në një dasëm, rapsodët Hashim Shala e shoku i tij, tani i ndjerë Tahir Drenica, ishte një ngjarje e cila u mbajt mend një kohë të gjatë. Mbahet mend se në fshatin Paldenicë kanë marrë pjesë në dasma edhe Myrtezan Ferati me harmonikën e tij si dhe Fetah Buçi e Muharrem Dardhishta nga Shkupi.

Krahas kësaj, pas LDB-së, aktivitete kulturore jo të rralla kishte edhe në shkollën fillore „Tefik Çanga", ku nxënësit në festat që organizoheshin asaj kohe, shfaqnin programe argëtuese duke filluar nga recitimet, këngët shkollore, skeçe të ndryshme, por s`duhet harruar as dramat që ata arritën t`i vejnë në skenë.

Në rrjedhë të kësaj që u shkrua këtu e më lartë, kuptojmë se treva e Hanit të Elezit, kishte paraprakisht një trashëgimi kulturore të begatë e cila u trashëgua nga brezat që po treteshin nën lisa, por kjo trashëgimi e mbetur te brezat e rinj, kishte nevojë të ngritej në një nivel më të lartë, në një nivel më të organizuar dhe më frytdhënës, andaj formimi i një shoqërie artistike në trevën e Hanit të Elezit, lindi si imperativ dhe nevojë e kohës, lindi si një vullnet shpirtëror i qytetarëve.

[11] Informatë nga Selman Curri, dhënë autorit më 23.12.2013, Hani i Elezit
[12] Informatë nga Shaban Rogaqi, dhënë autorit më 29.12.2013, Hani i Elezit

Motiv dasme në odat tona, punim i artistit Aman Kuka

Periudha kohore 1974 - 1981

Si dhe kur u themelua SHKA „Sharri" në Han të Elezit

Rrethanat e caktuar politike, herë vështirësuan e herë lehtësuan jetën kulturore jo vetëm në Han të Elezit, por edhe në mbarë Kosovën. Demonstratat e vitit 1968 në Prishtinë për Flamur e Universitet, kishin hapur një kapitull të rëndësishëm për zhvillimin e gjithëmbarshëm të popullit shqiptarë në trevat e pushtuara. Shqiptari nuk mund të mbahej më zap si më parë, andaj në këto rrethana u formuan Shoqëri të ndryshme artistike në gjithë Kosovën, dhe ku më shumë e ku më pak, aktivitetet kulturore morën një kahe të dëshiruar, por gjithnjë aty ku duhej të përmendur Shqipëria, zëvendësohej me emrin Malësia, por spektatori e kuptonte se për kë ishte fjala. Në këto rrethana të caktuara shoqërore-politike, edhe në trevën e Hanit të Elezit, atëherë me status të Bashkësisë Lokale, që gravitonte në komunën e Kaçanikut, filloi iniciativa për formimin e një Shoqërie kulturore-artisike.

Për të zbërthyer periudhën 40 vjeçare të këtij aktiviteti, menduam se më së mirë është t`i bartim kujtimet e veteranëve të kulturës muzikore, përkatësisht artistëve të cilët ishin edhe kreatorët e SHKA,,Sharri" në Han të Elezit. Pavarësisht se kujtimet e tyre mund të jenë të ndryshme, boshti i aktivitetit është në afërsi të njëri tjetrit dhe në një farë mënyre plotësojnë historikun e kësaj Shoqërie .

Nuriman Kuka, njëherit edhe kryetari i parë i SHKA „ Sharri ", kujton:

Fabrika e çimentos ,,Sharri" ishte një gjigant ekonomik, dhe si i tillë kishte të punësuar një numër të madh punëtorësh nga treva jonë. Në këtë fabrikë punoja edhe unë, por në fabrikë punonin edhe punëtorë të tjerë të cilët krahas punës që bënin, kishin edhe afinitete arti dhe herë-herë, në vend të pushimit, disa punëtor

hidhnin valle ashtu spontanisht, kurse ndonjë tjetër, pranë makinës ku punonte, ia kriste këngës, kështu që bashkë me vallet dhe këngët e këtyre punëtorëve, argëtoheshin edhe punëtorët e tjerë. Këto këngë dhe valle të shpeshta, një ditë vendosëm t`i formësojmë, deshëm t`i organizojmë, kështu që në vjeshtën e vonë të vitit 1974, në bashkëpunim me shkollën fillore ,, Tefik Çanga", përkatësisht me drejtorin e kësaj shkolle, ramë në ujdi për një program të përbashkët, ndërmjet një grupi të valltarëve : Nuriman Kuka, Adem Shkreta, Ahmet Berisha, Adem Bushi, Bajram Vila dhe këngëtarëve nga fabrika e çimentos dhe nxënësve të shkollës fillore. Koncertin e dhamë në mësonjëtoren e katit të dytë i mbushur dëng dhe u mirëprit mjaftë mirë nga të pranishmit. Në këtë koncert shkollor, ne punëtorët u paraqitëm me valle, ndërsa nxënësit e realizuan pjesën tjetër të programit. Ishte një program i mirë dhe u mbajt mend shumë kohë. Ky ishte koncerti ynë i parë, atëherë kur shoqërie ende s`ishte formuar zyrtarisht dhe nuk e kishte as emrin.

Koncerti i dhënë në bashkëpunim me nxënësit e shkollës fillore dhe pritja e mirë që u bë nga të pranishmit, nxiti artdashësit të ndërmarrin edhe hapa të tjerë organizativ.

Për formimin e Shoqërisë ne gjetëm përkrahje nga drejtori i fabrikës Avdulla Hoxha, nga drejtori teknik Ismail Lika, si dhe Liman Dema, kryetar i sindikatës. Në bashkëpunim me Adem Shkretën e Faruk Dacin u munduam të bëjmë një kryesi sa më të gjerë. Kështu që në prezencë edhe të drejtorëve të vijave të prodhimit si, Sinan Koxha e Naim Daci vendosëm që të themelohet Shoqëria artistike e cila mori emrin e kombinatit,, Sharri". Në këtë takim, unë Nuriman Kuka u zgjodha kryetar, Faruk Daci, zv. Kryetar, Rrahman Axhami, sekretar. Ndërsa

anëtarë të kryesisë u zgjodhën: Sami Vila, Kadri Ballazhi, Vebi Ballazhi, Veli Sahiti, Sejdi Dernjani , Bajram Vila.
Pas themelimit të Shoqërisë dhe kryesisë, u formuan edhe seksionet e shoqërisë si ai i instrumentalistëve, grupi i valleve, ai i folklorit dhe i dramës.
Orkestrinën e udhëhiqte Veli Sahiti, Grupin e solisteve e udhëhiqte Ajshe Axhami, Grupin e folklorit e udhëhiqte Sejdi Dernjani, ndërsa atë të dramës Faruk Daci, kurse grupin e valleve e udhëhiqte Adem Shkreta.
Pas koncerteve të dhëna në vitin 1976 në Kosovë, një koncert e dhamë edhe në Hasanbeg të Shkupit, në shtëpinë e kulturës. Për këtë koncert më ndihmoi Bajram Zeqiri i cili babain e kishte hoxhë në Seçishtë, ndërsa ai jetonte në Hasanbeg dhe ishte anëtar i shoqërisë artistike të Hasanbegut. Atje shkuam me autobus të fabrikës. Veshjet kombëtare i huazuam nga shoqëria ,, Emin Duraku" e Shkupit, ndërsa herave të tjera i kemi marrë edhe nga Shoqëria,, Xheladin Zeqiri" nga Tetova me ndihmën e Emine Cekës.
Pas këtij suksesi, vullneti për koncerte u shtua edhe më shumë. Anëtarët e shoqërisë kërkonin nga unë dhe kryesia që sa më tepër të jepnim koncerte. Fal punës së palodhshme të kryesisë dhe anëtarëve të shoqërisë, u arrit që të shkojmë në Kumanovë.
Koncerti ynë në Kumanovë ishte propaganduar edhe nga Radioja e Kumanovës dhe në shtëpinë e kulturës kishin ardhur shumë qytetarë. Meqenëse salla ishte e vogël për t`i pranuar atë numër të madh të spektatorëve, u vendos aty për aty që atë koncert ta mbajmë në shtëpinë e armatës dhe ashtu u bë. Vlen të ceket se në koncert , pos qytetarëve, morën pjesë edhe strukturat udhëheqëse shqiptare të Kumanovës të asaj kohe dhe u krijua një lidhje shumë e mirë e bashkëpunimit në mes nesh.

Pas përfundimit të programit, na dërguan në darkë neve me gjithë shoqërinë artistike nga Hani i Elezit dhe kjo mbeti një kujtim i paharruar për mua dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë.
Pas kësaj, ne ftuam shoqërinë artistike të Kumanovës ,, Avdulla Shabani" për një koncert në Han të Elezit dhe në bashkëpunim me kryesinë e Shoqërisë dhe atë të sindikatë së fabrikës, shkuam i morëm me autobus. Koncerti u dha në sallën e kinemasë edhe për punëtorë edhe për qytetarë dhe u mirëprit nga artdashësit e Hanit të Elezit.
Sa mbaj mend, brenda Kosovës, koncerte kemi dhënë në:
Drenas (Gllogovc), Kastriot (Obiliq), Pozhoran, Kaçanik, Kaçanik të Vjetër, Shkup dhe natyrisht disa sosh në Han të Elezit.
Fillimisht nuk kishim veshje kombëtare, por me iniciativën e Faruk Dacit, morëm materialin filtrues (fillc) i cili në fabrikë përdorej kundër pluhurit, por që ishte i mirë dhe i përshtatshëm për qepjen e veshjeve kombëtare. Me sa më kujtohet veshjet i kemi qepur në Shkup te rrobaqepësi Latif Lubishta, ndërsa gajtanët i blemë në Prizren apo në Gjakovë. Kështu i siguruam veshjet e meshkujve, ndërsa veshjet e femrave i siguruam kush si mundi nëpër shtëpia. Instrumentet i blemë në Ferizaj, 5 sharkia e 10-12 çiftelia. Ushtrimet fillimisht i kemi zhvilluar Te vila në fabrikë, pastaj në Shtëpinë e të Vetmuarve. Sa mbaj mend, nga viti 1974 e deri në vitin 1981 , shoqëria kishte rreth 40 anëtarë aktiv. Në këtë aktivitet ishte e përfshirë edhe gjinia femërore, por pas shumë lutjeve e kërkesave që u bënim prindërve. Gjatë kësaj periudhe me këngë shquheshin: Ajshe Axhami, Lumturie Axhami, Muhamet Ramuka, Suzana Brava, Shemsie Kuqi, Emine Ceka, Sejdi Dernjani, Avidane Berisha, Indira Berisha, Ismet Kuka, Shaban Rogaqi dhe të tjerë që s`po më kujtohen. Në koncerte

kishim edhe pika muzikore me kavaj ku shquheshin: Hisen Kuka dhe Muharrem Shkreta.

Aktivitetin tim pranë kësaj shoqërie e kam përfunduar në vitin 1981, pas demonstratave, më saktë më 24.5.1981, një ditë para stafetës së Titos. Jam përjashtuar nga shoqëria me vendim të Komitetit komunal të Kaçanikut, përkundër këmbënguljes së kryesisë që unë s`kam arsye të shkarkohem, përkatësisht të përjashtohem. Përkundër kësaj, unë të nesërmen shkova me anëtarët e Shoqërisë në Kaçanik dhe u rreshtova në binë, por më detyruan të tërhiqem nga bina përkundër reagimit anëtarëve të Shoqërisë ,, Sharri", kujton Nuriman Kuka.

Masat politike që u ndërmorën ndaj Nuriman Kukës dhe shumë të tjerëve në komunën e Kaçanikut, kishin për qëllim futjen e frikës ndër njerëz, mosbesimin ndaj njëri tjetrit dhe janë të shkruara edhe në një material prej 8 faqeve i titulluar Informatë[13], në të cilën raportohej për masat ndëshkuese në të gjitha OTH të LK[14] gjatë diferencimit ideo-politik, antishqiptar prej 11.3. 1981 - 15.8.1981. Në kuadër të këtyre diferencimeve është edhe emri i Nuriman Kukës i cili largohet nga LK, është shkarkuar nga shefi i kuzhinës në fabrikë dhe është përjashtuar nga SHKA,, Sharri".

Sejdi Dernjani, kujton

Koncerti i parë u dha në vjeshtën e vonë të vitit 1974 dhe këtë viti e mbaj mend mirë pasi që në këtë vit u ktheva nga shërbimi ushtarak. Ishte një koncert i përbashkët në mes të punëtorëve të fabrikës dhe nxënësve të shkollës fillore dhe ai koncert u realizua në objektin e shkollës fillore ,, Tefik Çanga" në katin e dytë, aty ku sot është shkolla e mesme ,, Dardania".

[13] Naser Kuka ,, Nga lëvizja ilegale te UÇK, kujtime e dëshmi", Prishtinë 2012, fq. 478-479

[14] Organizata themelore e Lidhjes së Komunistëve

Në këtë koncert, nga grupi i valltarëve morëm pjesë: Bajram Vila, Adem Bushi, Nuriman Kuka.
Pos valleve që u ekzekutuan në këtë koncert, grupi i punëtorëve u paraqit edhe me këngë. Sejdi Dernjani dhe Ajshe Axhami u paraqitën me një këngë duet: ,, Ika nanës, ika babës, vetullzi i dadës" si dhe Avidane Berisha me këngën,, Kush ma i pari bani" të cilat u mirëpritën mjaftë mirë nga të pranishmit, kujton Sejdi Dernjani.
Para se të jepnim këtë koncert të përbashkët, ushtrimet i kemi zhvilluar Te mensa, ndërsa Xhavit Axhami kishte kontaktuar me Emin Gaxhën nga Shkupi dhe ishte marrë vesh që t`na ndihmonte herë pas here në koreografinë e valleve. Në vitin 1975, u formua edhe kryesia e Shoqërisë dhe kryetar u zgjodh Nuriman Kuka dhe njëkohësisht formuam edhe grupet e shoqërisë.
Grupin folklorik e përbënin:
Sejdi Dernjani(çifteli) , fillimisht i vetëm, ndërsa më vonë Ekrem Rogaqi (sharki), Misim Tuçi, (çifteli), Ismet Kuka, (çifteli), Naser Kaloshi, (fyell) dhe Emrush Ferizi, (def).
Pas pak kohe, nga grupi largohet Naser Kaloshi e në vend të tij e aktivizuam Fadil Vilën nga Gurana. Aktivitetin ndërkohë e ndërprejnë edhe Misim Tuçi e Ekrem Rogaqi, kështu që për tre vite me radhë do të mbetem i vetëm në këtë grup dhe po i vetëm kam marrë pjesë në shumë koncerte qoftë në Han të Elezit, në Kaçanik, Kastriot (ish Obiliqi), Pozhoran, etj. Grupin e kemi kompletuar për të dytën herë në vitin 1978-1979 kur morëm anëtarë të ri si: Shaban Çupin, Shaban Rogaqin, Ekrem Rogaqin, Ismet Kukën dhe kishte raste kur në ndihmë grupit i vinte edhe Shaip Livoreka nga Kaçaniku si dhe Nejazi Curri e Nehat Curri nga Shkupi.

Në Maqedoni , koncerte kemi dhënë në Hasanbeg të Shkupit dhe në Kumanovë, ku ishin të pranishëm një numër i madh shikuesish dhe si Shoqëri u ndamë shumë të kënaqur. Nga koncerti në Kumanovë rezultoi edhe bashkëpunimi me Shoqërinë ,, Avdulla Shabani" të cilën e ftuam për një koncert edhe në Han të Elezit, i cili edhe u realizua dhe u mirëprit nga artdashësit hanelezas.

E pamundur është të mos kujtoj , ndër të tjera edhe koncertin në Kastriot(ish Obiliq) ku moderatori Emrush Dernjani më bëri një paraqitje të mirë dhe pasi këndova këngën që ishte i paraparë në repertorin e këngës, shikuesit brohorisnin ,, edhe një , edhe një" dhe unë pa hezitim dola nga linjat e repertorit të këngëve dhe këndova këngën e Bardhok Bibës e cila u mirëprit me duartrokitje frenetike. Për këtë koncert shkroi edhe gazeta e punëtorëve të Kastriotit dhe në ballë kishin vendosur fotografinë time, të cilën fotografi ma dërguam më vonë nëpërmjet postës. Ky koncert është realizuar në vitin 1976. Veshjet kombëtare i siguruam nga filtri që përdorej kundër pluhurit dhe i qepëm në Shkup, ndërsa gajtanët i blemë në Prizren. Gjatë këtyre viteve kemi dhënë një numër të madh koncerteve për të gjitha festat që ishin në trevën tonë, duke mos përjashtuar edhe ardhjen e Fadil Hoxhës në përurimin e furrës 450 tonshe në fabrikën e çimentos.

Nga viti 1974 deri në vitin 1981, ushtrimet i kemi mbajtur në vende të ndryshme, si: Te villa në fabrikë, Te menza e punëtorëve dhe në Shtëpinë e të vetmuarve. Aktiviteti im ndërprehet dhunshëm nga Komiteti komunal i Kaçanikut, pasiqë sa herë që jepnim koncerte, repertori i këngëve, duhej të kalonte për verifikim të këngëve në Pleqësinë e Arsimit dhe të Kulturës dhe meqenëse unë shpesh herë dilja nga kornizat e këtij repertori, sidomos me këngën për Bajram Currin, pas demonstratave, në

prill të vitit 1981 më përjashtuan nga Shoqëria dhe nga kjo kohë fillova të merrem me gdhendjen e veglave muzikore.

Gjatë këtyre viteve (1974-1981) SHKA,,SHARRI" kishte një aktivitet të ngjeshur artistik. Pos grupit të folklorit, funksiononte edhe ai i këngëve popullore, i valleve dhe grupi i dramës.

Mbaj mend se këngët që i kam kënduar (popullore dhe folklorike) ishin:

Hajde Malenake, Kënga e Bajram Currit, Lulja e Gostivarit, duet me Ajshe Axhamin, Ti je si flutur, Oj mollë e kuqe, Moj ti çikë me kmish t`bardhë, Hajredin Pashën, Ushton Gryka e Kaçanikut, Shotë Galicës, etj.

Këngë për kimisten shqiptare me tekst dhe melodi timen, e cila këngë është kënduar edhe disa vite pas përjashtimit tim , është kënduar nga Shaban Rogaqi.

…

Erdh e reja prej malësie
Plot me bujari
Nisi punën si kimiste
T`gjithë ia kanë lakmi…

Mbaj mend se gjatë këtyre viteve, këngët e mia, të Ajshes dhe Lumturie Axhamit i kemi incizuar në një magnetofon në fabrikë, por më vonë dikush mbi shiritin e këngëve të incizuara me qëllim arkivimi, kishte incizuar këngë serbe, kujton ai.

Nga një repertor i këngëve të cilin e gjetëm te veterani i Shoqërisë, Sejdi Dernjani, mësojmë se Shoqëria ishte mjaftë e konsoliduar, funksiononin të gjitha grupet e Shoqërisë dhe secila këngë e kënduar kishte mesazhin e vet. Në anën tjetër mësuam edhe emrat e këngëtarëve si dhe këngët që i kanë kënduar ata.

1. Valle popullore dibrane
2. Sejdi Dernjani, me këngën: Vishet goca

3. Avidane Berisha(tani e ndjerë): Prej Zemanit
4. Sabit Kurti(tani i ndjerë) : Elbasan i bukur
5. Valle popullore
6. Nexhmedin Laçi: Shtatë parë lodra
7. Ajshe Axhami: Roja e ditës
8. Ali Bushi: Moj Feride
9. Indirane Berisha: A del për mua pranvera (kitarë)
10. Ramiz Livoreka: Një këtë kangë që jam tuj këndue
11. Valle popullore
12. Ismet Kuka: Moj e keqe je ba si sorrë
13. Ajshe Axhami: Dëshirova me t`pa ty
14. Valle e meshkujve

Fahredin Shkreta, kujton

Njëri nga veteranët, që në orët e para iu bashkëngjit aktivitetit kulturor në trevën e Hanit të Elezit, është edhe Fahredin Shkreta i lindur në vitin 1949. Për aktivitetin e SHKA„Sharri" viteve të 70-ta thotë:

Shoqëria Kulturore Artistike „ Sharri'' është themeluar në vitin 1975 dhe në të njëjtin vit, kemi dhënë edhe një koncert të përbashkët me nxënësit e shkollës fillore. Koncertin e dhamë në objektin e shkollës fillore dhe në grupin e valltarëve nga fabrika e çimentos kemi marrë pjesë: Unë, Nexhmedin Laçi, Avdulla Zeqiri, ndërsa kanë kënduar Ajshe Axhami e Sejdi Dernjani, por mbaj mend se krahas të tjerëve, instrumentalist ka qenë edhe Veli Sahiti nga Ferizaj. Krahas këtij koncerti, ne kemi marrë pjesë edhe në koncerte të tjera gjatë vitit 1976, 1977, 1978 dhe më kujtohet se krahas koncerteve në Han të Elezit, kemi marrë pjesë edhe në Hasanbeg, në Shkup, Kumanovë, Viti, Kastriot (Obiliq). Unë kam marrë pjesë në grupin e valleve dhe para publikut jemi paraqitur me vallen e Gjilanit, të Shotës, të cilën e luante Bajram Vila si dhe

Vallen e Burrave. Në kuadër të Shoqërisë kam qenë përgjegjës për disiplinë dhe nga aktiviteti i SHKA-as jam ndarë në vitin 1978, duke shtuar edhe një fakt tjetër se ishte kënaqësi të ishe anëtar i kësaj Shoqërie sepse ishte një vullnet i madh nga të gjithë anëtarët e Shoqërisë për avancimin e kulturës shqiptare në trevën e Hanit të Elezit, kujton ai.

Ali Bushi, kujton

Ndër veteranët, që kontribuan në zhvillimin e jetës kulturore të Shoqërisë Kulturore Artistike ,, Sharri" është edhe Ali Bushi nga Puset e Nikës, tani me vendbanim në Kaçanik i cili me klarinetën e tij sjellte tingujt dhe melodité e bukura në kuadër të orkestrinës së SHKA,,Sharri''.

Duke kujtuar aktivitetin e tij të gjatë në kuadër të kësaj Shoqërie ai kujton:

SHKA,,Sharri" është formuar herët. Ndër themeluesit e kësaj Shoqërie isha edhe unë. Kryetar ishte Nuriman Kuka, ndërsa në Këshill bënin pjesë edhe Rrahman Axhami, Kadri Ballazhi, Faruk Daci,etj. Sa më kujtohet, programin e parë e kemi mbajtur në shkollën fillore ,, Tefik Çanga" në vitin 1973.

Faruk Daci, kujton

I takonim gjeneratës së re të Hanit të Elezit dhe si të tillë, kishim nevojë për aktivitete kulturore e sportive. Aktivitete të tilla organizoheshin edhe nga arsimtarët për programe festive shkollore, por aktivitete të organizuara nga qytetëza nuk kishte. Duke i pasur parasysh këto, filloi edhe iniciativa për themelimin e Shoqërisë.

Më kujtohet se, themelimit të Shoqërisë i kanë paraprirë dy koncerte të përbashkëta me nxënësit e shkollës fillore në vitin 1975 për festën e 29 nëntorit dhe atë të 22 dhjetorit. Në kuadër të

programit të përbashkët për këto festa, ne u paraqitëm me dramën e Kristo Floqit „Vëllezërit interes" dhe një valle. Zyrtarisht, Shoqëria është themeluar në shkurtin e vitit 1976 dhe kryetar i Shoqërisë u zgjodh Nuriman Kuka, kurse antarë të kryesisë ishin: Faruk Daci, Rrahman Axhami, Kadri Ballazhi, Bajram Vila, Vebi Ballazhi, Adem Shkreta e Sami Vila, ndërsa orkestrinën e udhëheqte Veli Sahiti, grupin e folklorit Sejdi Dernjani, të valleve Adem Shkreta, ndërsa atë të dramës Faruk Daci. Aktorët që luajtën në realizimin e dramave ishin: Faruk Daci, Bajram Zeqiri, Zebushe Vila, Bahrije Hashani, Avidane Berisha e Indira Berisha. Në realizimin e valles , morën pjesë: Fahredin Shkreta, Nexhmedin Laçi, Avdulla Zeqiri, Ahmet Berisha. Më vonë grupit të valleve i bashkangjitet edhe Mersije Daci, ndërsa si soliste erdhën Shemsie Kuqi, Makfirete Kyçyku e Emine Ceka ndërsa si soliste dhe njëkohësisht moderatore ishte Ajshe Axhami. Në grupin e kavajve bënin pjesë: Muharrem Shkreta e Isen Kuka, ndërsa veshjet kombëtare i kemi siguruar nga fillci dhe qepjen e tyre e kemi bërë në Shkup. Koncerte kemi dhënë fillimisht në Han të Elezit dhe jemi pritur mirë. Me mjete materiale na ndihmonte fabrika e çimentos, ndërsa udhëtimin e bënim me autobusin e fabrikës. Pavarësisht se çdo fillim është i vështirë, ne arritëm të kemi shumë rezultate dhe arritëm që koncerte të japim edhe në Kastriot (Obiliq), Kaçanik, Pozhoran, Drenas (Gllogovc) madje edhe në Hasanbeg dhe Kumanovë, ndërsa na dështoi, për shkaqe objektive, koncerti në Preshevë.

Mendoj se themelimi i Shoqërisë ishte një veprim i arsyeshëm. Banorët e kësaj treve kishin nevojë për një organizim të tillë dhe kjo Shoqëri ka dhënë rezultate të shumta. Anëtarët e Shoqërisë ishin aktiv, ushtrimet ishin të rregullta dhe disiplina në nivelin e duhur.

Pas shkarkimit të Nuriman Kukës në majin e vitit 1981, kryetar i Shoqërisë zgjidhet Adem Shkreta, ndërsa unë zgjidhem nga tetori i vitit 1984, të cilën detyrë e kryej deri në vitin 1990 dhe gjatë kësaj periudhe SHKA„Sharri'' korri në varg rezultatesh në Festivale dhe kjo edhe sot më bën të ndjehem i lumtur, kujton ai.

Dokumentet relevante për themelimin e SHKA„Sharri"

Pas koncertit të mbajtur te shkolla fillore në vitin 1974 dhe pas suksesit që arritëm në paraqitjen e parë publike, interesimi për formësimin e Shoqërisë rritej edhe më shumë, andaj, gjithnjë duke u futur në thellësi të kohës dhe hulumtimin duke e përballur me fakte e rrethanorë të tjerë, na del e saktë se koncerti i parë në mes të grupit të punëtorëve dhe nxënësve të shkollës është mbajtur në vitin 1974, ndërsa dy koncerte të tjera të përbashkëta me nxënësit e shkollës fillore, janë realizuar në nëntorin dhe dhjetorin e vitit 1975.

Në hulumtim të formimit të Shoqërisë„ Sharri" krahas subjektit njeri, ne shfrytëzuam edhe dokumentacion relevant, gjithashtu i rëndësishëm për temën në trajtim. Arritëm t`i gjejmë dy dokumentacione: Një raport rasti i vitit 1980 i cili i referohet aktivitet të SHKA„Sharri" dhe gazetën informative të fabrikës së çimentos „Sharri" të cilat i shpalosim më poshtë.



HISTORIATI I SHKURTER I SHKA-se "SHARRI"

Shoqeria kulturo-artistike "SHARRI" u formua me 22.12.1975, mu edhe tani shvillon aktivitetet e saja ne gjiun e Ndermarrjes per prodhimin e materialit ndertimor "Sharri" Bani Elasit.

Frytet e pare te kesaj shoqerie u pane gysh me ne vitin e pare te formimit te saj edhepse ne fillim pati kushte te vashtire per shvillimin e aktivitetave, mirpo me pane dhe sotuaisen te pa kursyer qe troguan, shoqeria "Sharri" arritti suksese.

Dokument mbi themelimin e SHKA„Sharri"

Në Raportin e rastit, shkruan se : Shoqëria Kulturore Artistike „ Sharri" është formuar më 22.12.1975, duke vazhduar

më poshtë me shkrimin prej një faqe, i shtypur në makinë shkrimi, ku pasqyrohet aktiviteti përmbledhës i kësaj shoqërie deri në vitin 1980.

Fakti tjetër që e vërteton themelimin zyrtar të Shoqërisë në vitin 1975 është edhe numri i parë i revistës së punëtorëve „ Sharri" e datës 4 korrik 1978, ku në kuadër të një artikulli për jetën kulturo-zbavitëse, gazetari i kësaj reviste shkruan edhe për Klubin e Futbollit „Sharri", por e përmend edhe SHKA„Sharri", ku ndër të tjera thuhet se:

...Në të mirë të kësaj flet edhe veprimtaria e begatshme dhe e nduarnduartë e dy SHKA „Sharri" dhe „Bashkimi"[15] të cilat ndonëse nuk kanë kaluar më shumë se 3 vjet, me sukses po arrijnë ta zhvillojnë jetën kulturore zbavitëse. Si të reja, në gjirin e tyre kanë përfshirë nga 40 anëtarë aktivë. Amatorët e Hanit të Elezit me sukses arritën të formojnë një orkestër homogjen dhe të përgatisin koncerte të pasur me këngë e valle burimore...[16]

Këto dy fakte të shkruara janë edhe një argument më shumë për kohën se kur u themelua Shoqëria „Sharri" dhe s`kemi arsye t`i anashkalojmë, ashtu si nuk mund të kalojmë edhe faktin tjetër se koncerti i parë i përbashkët nga grupi i punëtorëve dhe ai i nxënësve të shkollës fillore „Tefik Çanga", tani me emrin tjetër Ilaz Thaçi, është mbajtur në fund të vitit 1974, andaj ky vit shënon edhe aktivitetin e parë të organizuar i cili kishte një qëllim, kishte një objektiv, argëtimin e nxënësve, arsimtarëve, prindërve, me një fjalë të qytetarëve.

Meqë raporti i rastit, saktëson se SHKA„Sharri'' u themelua në dhjetorin e vitit 1975, atëherë mbetet të kuptohet se kryesia e

[15] SHKA„Bashkimi" në fabrikën e gëlqeres në Kaçanik

[16] Sharri, gazetë informative e OPB „Sharri" Hani i Elezit, nr.1, 4.7.1978

zgjeruar është themeluar në shkurtin e vitit 1976, ashtu siç thotë në kujtimet e tij edhe Faruk Daci.

Nga një dokument (raport rasti) i shkruar i vitit 1980, për aktivitetin e kësaj shoqërie thuhet se:

Shoqëria Kulturore Artistike „ Sharri" u formua më 22 dhjetor 1975, ku edhe tani zhvillon aktivitetet. Frytet e para të kësaj shoqërie u panë qysh se në vitin e parë të formimit të saj, edhe pse në fillim pati kushte të vështira për zhvillimin e aktiviteteve, mirëpo me punë dhe entuziazëm të pa kursyer që treguan, shoqëria Sharri, arriti suksese. Në vazhdim të këtij dokumenti më tej thuhet se kjo shoqëri, aktivitetin e saj e zhvillon në gjiun e Ndërmarrjes për Prodhimin e Materialit Ndërtimor „ Sharri", duke e përmendur edhe një fakt tjetër se gjatë vitit 1977-1979 ka pasur mungesë kuadri dhe kushte materialo-financiare, andaj edhe aktiviteti i saj u zhvillua me një temp paksa më të ngadalshëm dhe njëkohësisht kërkohej që aktivitetit të kësaj shoqërie t`i bashkëngjiten edhe artdashës nga fabrika e „ Salonitit" dhe „ Ina-Okit"

Në anën tjetër, në këtë dokument, i cili më së shumti i ngjan një raporti të dhanë para organeve përkatëse, thuhet se kjo shoqëri, krahas koncerteve të dhëna para punëtorëve të kësaj fabrike, koncerte ka dhënë edhe para publikut të Hanit të Elezit, Kaçanikut, Pozhoranit, Drenasit (ish Gllogovcit), Skenderajve (ish Sërbica) si dhe koncertet e realizuara në Kumanovë e Shkup.[17]

[17] Burimi: Arkivi i SHKA„SHARRI"- Historiati i shkurtër i SHKA„SHARRI", shkrim njëfaqësh i shkruar me makinë shkrimi



HISTORIATI I SHKURTER I SHKA-se "SHARR"

Shoqeria kulturo-artistike "SHARRI" u formua me 22.12.1975, ku edhe tani zhvillon aktivitetet e saja ne gjiun e Ndermarrjes per prodhimin e materialit ndertimor "Sharr" Hani Elezit.

Frytet e para te kesaj shoqerie u panë qysh se ne vitin e pare te formimit te saj edhepse ne fillim pati kushte te veshtira per zhvillimin e aktivteteve,mirpo me punë dhe entuziazem te pa kursyer qe treguan, shqqeria "Sharri" arrijti suksese.

Po permendim se SHKA "SHARRI" per shkak te kushteve materialo-finansiare si dhe nga mungesa e kusdrit qe pati gjat periudhes 1977-1979, aktiviteti i saj u zhvillue me nje tempo me te ngadalshem.

Mirpo duke pare te rinjet e NPMN "SHARRI" nevojen per aktivtetet qe i perkasin te rinjeve, Konferenca aksionale e LRS ne mbledhjen e mbajtur me 12.02.1980, muarr qendrimet e saja qe SHKA-te aktivizohet ku dhe arriti qellimin.

Keshtuqe, gjat vitit 1980 SHKA "SHARRI" zgjodhi organet e veta dhe keshtu u zgjua nga gjumi duke dhene programe te saja me melosin tone popullor-pera punetoreve te OP "SHARR" si dhe ne disa mese tjera, si p.sh. dhenje e disa koncertove para qyteterave te kesaj BL, para publikut te Kaçanikut, Pozhoranit, Gllogovcit, Serbices si dhe koncerti i fundit i çfaqur ne RS te Maqedonis ne Kumanov, ku me te vertet u pranuan sukseset e kesaj Shoqerie.

Per rezultatet dhe sukseset qe pati SHKA "SHARRI" gjat periudhes se kaluar duhet veçuar kryesin e SHKA-se si dhe anetaret te cilet marrin pjese, te shkolles fillore "Tofik Çanga" nga Hani Elezit, kurse eshte mungesa e pjesmarrjes te te rinjeve te OBPB, "Salloniti" dhe te OBPB "Lepenci", andaj therrasim aktivistet e katyre OBPB-ve qe t`iu bashkangjiten aktivitetit te kesaj shoqerire, njeherit iu bejme ftese edhe aktivisteve te Organizates punuese INA-OKI Hani Elezit per kete aktivitet.

Faksimile nga „Historiati i shkurtë i SHKA„Sharri”

Nga Albumi i SHKA„Sharri” i viteve të 70-ta

Vitet shkojnë, por kujtimet mbesin, veteranët e SHKA ,,Sharri", fotografi e vitit 1976[18]

Ulur nga e majta: Emrush Ferizi, Veli Sahiti[19] e Rrahman Axhami. Në këmbë, nga e majta: Mersije Daci, me harmonikë i panjohur, Sadik Sadiku me kitarë nga Terni i Ferizajt, i vdekur në vitin 1987, Adem Bushi i vrarë nga serbët në vitin 1999, Ajshe Axhami, Avidane Berisha (tani e ndjerë), Ibrahimi... dhe Sejdi Dernjani.

Kjo fotografi, sa dëshmuese aq edhe historike, në kuptimin e historikut të SHKA „Sharri", në vetveten e saj flet mjaftë. Rreth kësaj fotografie mbështjellet ai organizimi i parë, duke i shtuar edhe të tjerët që i përmendëm më lartë si themelues të kësaj Shoqërie. Në kuadër të kësaj fotografie është edhe Ajshe Axhami,

[18] Fotografi e marrur nga Sejdi Dernjani, Paldenicë

[19] Veli Sahiti, marrëdhënien e punës pranë shkollës fillore „Tefik Çanga"(tani Ilaz Thaçi) e ka lidhur me datën 16.12.1975, ndërsa e ka ndërprerë me datën 13.8.1977. Burimi: Arkivi i shkollës fillore „Tefik Çanga"- Libri i amzës

një soliste e dalluar e Shoqërisë viteve të 70-ta. Ajo me këngët e saja ishte e mirëpritur nga qytetarët e kësaj treve dhe ka lënë gjurmë të thella në jetën kulturore në Han të Elezit e aq më tepër kur atyre viteve, femra e kishte vështirë të merrej me një aktivitet të tillë.

Foto e vitit 1976, nga e majta: Sejdi Dernjani, Ekrem Rogaqi, Misim Tuqi, Naser Kaloshi, grupi folklorik i SHKA„SHARRI" të cilin për vite me radhë e udhëhoqi Sejdi Dernjani.

Foto e vitit 25 maj 1977, nga e majta: Fadil Vila, Sejdi Dernjani, Shaip Livoreka, Emrush Ferizi e Ismet Kuka

Fotografi e vitit 1978, nga e majta: Fadil Vila, Sejdi Dernjani, Shaip Livoreka, Emrush Ferizi e Ismet Kuka, të cilët çdoherë u mirëpritën mirë nga publiku. Ata me tingujt e çiftelisë dhe nëpërmjet zërit melodik të fyellit, argëtonin qytetarët e kësaj treve. Grupi folklorik i Shoqërisë u mirëprit mirë edhe në Festivale e koncerte që u mbajtën në qytetet e tjera të Kosovës.

Nën tingujt e grupit folklorik, valltarët e Shoqërisë, Mersije Daci e Bajram Vila (tani i ndjerë), gjatë një koncerti në vitin 1978, me vallen e bukur të Shotës.

Ndër aktivitetet tjera, që anëtarët e kësaj Shoqërie kanë mbajtur në mend, është edhe ai i vitin 1979. Një pjesë e grupi folklorik të SHKA,,SHARRI" në përbërje të: Shaban Rogaqit, Ismet Kukës, Shaip Livoreka e Ekrem Rogaqi, morën pjesë në Festivalin ,,Gllogovci 79" dhe Ekrem Rogaqi mori çmim në të holla për valle instrumentale më të mirë, ekzekutim me sharki. Ekrem Rogaqi ishte pjesëmarrësi më i ri në këtë festival, ishte vetëm 16

vjeç[20]dhe siç thotë ai, me ato të holla kam blerë një çifteli dhe një sharki.

Grupi i valltarëve, nga e majta; Fahredin Shkreta, Nexhmedin Laçi e Avdulla Zeqiri në vitin 1976

[20] Informatë nga Ekrem e Shaban Rogaqi dhënë autorit më 29.12.2013, Hani i Elezit

SHKA „ SHARRI’’ 1982-1990

Qytetëza e Hanit të Elezit në vitin 1986[21]

Pas përjashtimit nga Shoqëria të Nuriman Kukës, kryetar i shoqërisë zgjedhet Adem Shkreta, ndërsa nga tetori i vitit 1984 e

[21] Fotografi të marrura nga Monografia „Sharri" 1936-1986, në 50 vjetorin e fabrikës së çimentos në Han të Elezit

deri në vitin 1990 Faruk Daci[22], ndërsa anëtarë të kryesisë ishin: Nexhmedin Daci, Llukman Vila (i ndjerë), Veli Bushi (i ndjerë), Lumni Berisha e Naim Axhami[23]. Kështu fillon edhe faza e dytë e aktivitetit të kësaj Shoqërie e cila korri një varg rezultatesh viteve të 80-ta.

Tanimë kjo Shoqëri, pavarësisht se kalonte periudhën amatore, ajo kishte marrë udhën e saj. Arritën që me sukses në skenë të shfaqin këngët dhe vallet e bukura, andaj edhe krijuan një përvojë me publikun e krahas kësaj krijuan edhe një identitet institucionale. Gjatë kësaj periudhe Shoqëria pranoi edhe anëtarë të rinj e në mesin e tyre edhe Shengyle Berishën.

Në kuadër të shoqërisë, aktiv ishin grupi i muzikës popullore, ai folklorik, grupi i valleve si dhe ai i dramës.
Orkestrina kishte këtë përbërje[24]:
Fadil Vila, harmonikist
Selman Vila , harmonikist
Hazizi nga Komogllava, harmonikist
Nehat Curri, klarinetist
Ali Bushi, klarinetist
Destan Kryeziu, klarinetist nga Shkupi
Shaban Rogaqi, violinist
Muharrem Rogaqi, violinist
Sefer Rogaqi, defist
Remzi Ballazhi, defist
Emrush Ferizi, lodër
Vëllezërit Aliu nga Shkupi, pas vitit 1985

[22] Informatë nga Faruk Daci , dhënë autorit më 17.1.2014, Hani i Elezit
[23] Informatë nga Faruk Daci
[24] Informatë marr nga Shengyle Berisha, Shaban Rogaqi,Nejazi Dernjani e Rrahman Curri

Agim Kamishi, kitarist nga Shkupi
Melari Reçi, defist nga Shkupi
Grupi i folklorit:
Ismet Kuka, përgjegjës
Shaban Rogaqi, Sali Kuka, Nejazi Dernjani, Ekrem Rogaqi, Muharrem Rogaqi, Halil Rogaqi, Sefer Rogaqi, Rrahman Curri, Nexhat Ballazhi, Xhelal Kalisi, Nesim Curri, Mehmet Isufi, Imer Brava, Misim Tuçi, Fadil Vila, Fevzi Rogaqi, Servet Hasallari, Naim Thaçi, Musa Brava, tani i ndjerë
Grupi i solistëve, këngëtarëve
Shaban Rogaqi, Shengyle Berisha, Lumturie Axhami, Teuta Berisha, Aqif Hoxha, Suzana Sazliu, Xhemile Laçi, Sulejman Vila Nadile Laçi, Fatmire Isufi, Lumnie Brava, Hidajete Vila, Nesim Curri

Grupi i valleve , vajzave[25]
Shengyle Berisha, Teuta Berisha, Suzane Sazliu, Fatmire Isufi, Lumturie Axhami, Suzana Brava, Sahadete Hoxha, Hidajete Vila.
Grupi i valltarëve, burrat[26]
Xhevat Shkreta, udhëheqës nga viti 1980-1989
Rabit Shkreta, Muhamet Berisha, Sabit Daci, Zejnulla Bela, Minir Luri, Imer Brava, Misim Tuçi, Ismet Kuka, Mehmet Isufi, Remzi Ballazhi.

Lumturie Axhami, kujton

Nëse ndalem dhe mendoj për kujtimet më të hershme të fëmijërisë, padyshim që gjithçka që më lidh me të është aktiviteti që kam pasur te SHKA ,,Sharri". Si fëmijë, me gjithë temperamentin që kisha, vazhdimisht ndiqja fshehurazi ushtri-met

[25] Informatë nga Xhevat Shkreta e Shengyle Berisha
[26] Informatë nga Xhevat Shkreta e Shengyle Berisha

që i mbanin anëtarët e kësaj Shoqërie. Nëse nuk gaboj, ishte viti 1978, sapo kishte mbaruar festivali i Gjirokastrës, te i cili dolën këngë shumë të bukura e që i dëgjonim fshehurazi në shtëpinë e gjyshit. Xhaxhai im, Naim Axhami pasi e vërejti se të gjitha këngët i dija përmendësh, një ditë më pyeti nëse dëshiroja të këndoja. Po, me kënaqësi, i thash. Atëherë shkova dhe u paraqita si anëtare. Isha fare e vogël (9 vjeçare). Atëbotë kryetar i Shoqërisë ishte z.Nuriman Kuka, përndryshe komshiu ynë që banonte afër banesës sime. Orkestrën e përbënin punëtorë që punonin në kombinat: Me harmonikë Azizi nga fshati Komogllavë, Ismaili, Sejdiu nga fshati Paldenicë, pastaj Muhamed Ramuka. Grupi folklorist nga fshatrat Seqishtë, Gorancë, Rezhancë etj, në mesin e tyre ishin: Ismet Kuka, vëllezërit Rogaqi, Fadil Vila etj. Ishim një rreth i ngushtë por çdo ditë e më shumë shtoheshin rradhët e pjesëmarrësve. Prezenca e femrave ishte jo aq e madhe, por më pas erdhën Shemsije Kuqi nga fshati Kotlinë dhe Xhemile Laçi. Problem tjetër kishim me veshjet të cilat i siguronim duke i huazuar nga shoqëritë tjera kulturo-artistike si ,,Emin Duraku" dhe ,,Ibe Palikuqja". Mu në këtë periudhë, aktiviteti im u zgjerua sepse njëkohësisht u bëra anëtare e SHKA "Emin Duraku". Paraqitja e parë në skenë ishte nën ombrellën e SHKA ,,Sharri", për stafetën e famshme të kohës ku u paraqita me këngën ,,Kam qëndisur një shami". Po të njëjtën këngë e regjistrova në programin e RTP. Më pas u mbajt një koncert komunal në Kaçanik në të cilin këndova këngën për Tefik Çangën, dhe u shpërbleva edhe me një çmim. Në shoqëri dita-ditës rritej numri i anëtarëve. Me frymë të re erdhën : Fatmire Jusufi, Hidajete Vila, Shengyle Berisha, Teuta Berisha, Suzana Sazliu etj. Ishte një fillim i mbarë. Filloi edhe grupi i vallëzimit që funksiononte. Ishte viti 1981, dhe unë meqë isha e re nuk i

përmbushja kushtet për pjesëmarrje në festivalin " Kosovarja këndon". Por gjithsesi unë mora pjesë në atë Festival, por pa të drejtë konkurrimi, vetëm si e ftuar e nderit për të përshëndetur festivalin si talente dhe yll i së ardhmes. Ja kështu si anëtare e SHKA „Sharri" e vendosa vulën e artistes. Më pas pasuan koncerte për ditën e çlirimit, për ditë të festave të ndryshme. Aktiviteti im s`kishte të ndalur deri në vitin 1984, ku pjesëmarrja në festivalin " Kosovarja këndon" do jetë vula më serioze dhe ëndrra e çdo artisteje të kap majat e popullaritetit. Aty u kurorëzova me vend të parë dhe shumë shpërblime të tjera. Edhe pse përfaqësoja një qytezë të vogël, me vete kisha të gjithë përgëzimet e bashkëvendësve të mi, të cilët më dhanë forcë për të mposhtur të gjitha pengesat dhe sfidat për të më kalitur në një figurë publike. Pas suksesit në festival, menjëherë pason editimi i albumit të parë " Sokolat e Dibrës" si prodhim i RTP- së. Të gjitha këto të arritura i referohen bashkëpunimit tim me SHKA „Sharri". Ju faleminderit që isha aq e vogël e më bëtë ambasadore të kësaj Shoqërie dhe kudo që shkoj t'iu bart me vete, kujton Lumturie Axhami.

Shaban Rogaqi, kujton

Me këngën jam shoqëruar si fëmijë. Gjyshi im Halili ish i burgosur politik i vitit 1948 dhe nëpër oda burrash ka kënduar këngë kreshnike. Në Shoqërinë „Sharri'' jam nga vitit 1978. Kam marrë pjesë në shumë koncerte e festivale, por kam kënduar në qindra dasma anë e kënd trojeve tona. Kënga më ka shoqëruar me shumë njerëz dhe kam arritur të njoh shumë artdashës anë e kënd atdheut tonë.

Si grup folklorik, krahas aktivitetit në Shoqëri, ne kemi marrë pjesë edhe në gazmende familjare dhe grupi ynë kishte këtë përbërje: Shaban Çupi, Shaban Rogaqi, Ekrem Rogaqi, Muharr-

em Rogaqi, Halil Rogaqi, Fevzi Rogaqi, Ismet Kuka, Sefer Rogaqi. Aktiviteti i Shaban Çupit në Shoqëri, ndërpritet pas burgosjes së tij për veprimtari politike në vitin 1985.

Në festivale nga më të ndryshmet, kam marrë çmime të para, diploma e mirënjohje. Shoqëria Kulturore ,,Sharri" ishte shtëpia ku na tubonte, na inkurajonte dhe ku shfaqnim melosin tonë popullor. Kam kënduar si solist, në duet e më së shumti në çifteli. Kam realizuar këngë origjinale në shumë studio të ndryshme si dhe në TV Prishtina, viteve të 80-ta, kujton ai.

SHKA ,,Sharri'' përkundër faktit që ishte Shoqëri amatore, dalëngadalë krijoi edhe repertorin e sajë të begatë dhe gjatë kësaj periudhe nëpër koncerte e festivale u kënduan këto këngë:

Yllkuqja e Kosovës, kënduar nga Shaban Rogaqi
Prej një shpati, kënduar nga Shengyle Berisha
Këngë për Asim Vokshin, Shengyle Berisha
Mori cucë syzezë, këngë duet nga Shaban Rogaqi e Shengyle Berisha
Kam qëndisur një shami, Lumturie Axhami
Këngë për Ibe Palikuqen, Lumturie Axhami
Shotë Galica, Shaban Rogaqi
Mora përpjetë kalanë, Shaban Rogaqi
Ani moj sharki, Shaban Rogaqi
Trëndafilin kur ta dhash, Shaban Rogaqi
Ka ra muzgu, Shaban Rogaqi
Mori vjollca që qel në saksi, Shaban Rogaqi
Më shikjon me buzë në gaz, Shaban Rogaqi
Lulja prej lules ban ferk, Shaban Rogaqi-Ismet Kuka
Se ç`na thirri djali në dasëm, Shaban Rogaqi, etj.

Çmimi më i dalluar i imi ishte ai i Festivalit të IX që u mbajt në Kaçanik më 15.11.1986 dhe nga dhjetë Shoqëritë më të dalluara të

Kosovës, SHKA ,,Sharri" mori vendin e parë , ndërsa unë si solist, mora Plaketën e artë të Festivalit. Pastaj shumë vende të para , pothuajse në çdo festival kemi marrë me duetin Shengyle Berishën. Kënga më e dalluara e imja, me tekst dhe muzikë timen e shkruar dhe e kënduar në vitin 1989, ishte kënga,, Diell e hanë shndrit n`këtë dhe", këngë e cila u mirëprit mirë nga dëgjuesit atëherë dhe sot dhe kjo këngë është kënduar edhe gjatë Luftës së UÇK-së, për ngritjen e moralit të ushtarëve për lirinë e atdheut.
Unë si këngëtarë aktiv në Shoqëri, bashkë me kushëririn tim Ekrem Rogaqin, ndikuam edhe në familjet tona dhe sot jemi pothuajse një Shoqëri në vete, kur merret parasysh numri i artdashësve në familjen tonë. Me kultivimin e vlerave muzikore merremi edhe sot, ndërsa djali im Kadri Rogaqi ka kryer shkollën e mesme të muzikës dhe vazhdon drejt sukseseve të reja në këtë lëmi.

Dueti: Shaban Rogaqi e Shengyle Berisha, të cilët viteve të 80-ta shkëlqyen në koncerte e festivale anë e kënd Kosovës dhe më gjerë

Shengyle Berisha, kujton

Hapat e parë në kulturën muzikore i kam bërë që në klasën e tretë fillore, ku mësues kisha tani të ndjerin Enver Ramadanin nga Ferizaj. Pastaj, më vonë fillova të këndoj si soliste dhe në kor. Anëtare e SHKA„Sharri'' jam nga viti 1981. Kam kënduar në orkestrinë, folklor, solo, duet dhe jam angazhuar edhe si valltare. Kam kënduar në shumë qytete të Kosovës si dhe të Maqedonisë. Kam marrë vendin e parë në Gllogovc me këngën „ Prej një shpati''. Vendin e parë kam marrë dy herë në Festivalin e Kaçanikut. Të njëjtin vend e kam marrë si duet edhe në vitin 1986 në Gjilan. Në Suharekë në vitin 1988, si Shoqëri dhe vendin e parë në duet e kam marr me Shaban Rogaqin. Në Mitrovicë, si grup kemi marrë vendin e dytë, ndërsa në këtë Festival mua më shpërblyen me gurë të çmuar të Trepçës. Kam marrë pjesë edhe në Kosovarja këndon 1982/83. Kam dhënë koncerte në Han të Elezit, Kaçanik, Gllobogicë, Ferizaj, Viti, Skënderaj, Gllogovc, Mitrovicë, por më kujtohet, se kam kënduar edhe në fshatin më të thellë të Kaçanikut, në Kërbliq, kur u elektrifikua ky fshat. Jam mirëpritur tepër mirë nëpër koncerte me këngën për Asim Vokshin, Prej zemanit, Mori cucë syzezë në duet me Shaban Rogaqin, si dhe me Selman Vilën gjithashtu në duet me këngën Or bilbil i malit, etj. Me këngën kam vazhduar edhe në Ansamblin „Emin Duraku'' të Shkupit, ndërsa në mërgim, në Norvegji, aktivitetin për këngën shqipe me kënaqësi e kultivoj edhe sot.

Kam realizuar dhe incizuar shumë këngë si në TV Prishtina, Radio Prishtinë dhe në studio të ndryshme, kujton ajo.

SUKSESE TË PAMOHUESHME

PËRFUNDOI «REVISTA E SHKA – vë TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT»

VENDI I PARË – SHKA «SHARR» NGA HANI I ELEZIT

Kaçanik, 1 nëntor

Mbrëmë në Kaçanik përfundoi «Revista e katërt e SHKA – ve të komunës së Kaçanikut», në të cilën morën pjesë 4 SHKA të komunës.

Në mbrëmjen e dytë u paraqitën dy shoqëri: SHKA «Rrezet e Sharrit» nga Biçeci dhe SHKA «Përparimi» nga Kaçaniku, të cilet publikut iu prezentuan me program të larmishëm, por jo edhe aq cilësor.

Pas përfundimit të programit juria e revistës si shoqëri më të suksesshme gjatë dy netëve, njëzërit shpalli SHKA «Sharr» nga Hani i Elezit, e cila do të përfaqësojë komunën e Kaçanikut në festivalin e SHKA – ve të Kosovës: «Kaçaniku 86», që do të mbahet kah muaji i muajit nëntor në Kaçanik.

D.SHEHU

Faksimile nga shkrimet e gazetës „Sharri" për Shoqërinë artistike si dhe shkrimin e gazetarit Daut Shehu në „Rilindjen"" e vitit 1986[27]

Për aktivitetin e SHKA „ Sharri " shkroi edhe gazeta informative e OPB„ Sharri"[28] në vitin 1986, e cila nëpërmjet bisedës me Shengyle Berishën, shpalosë sukseset e kësaj Shoqërie, shkrim të cilin po e japim si më poshtë.

Shoqëria Kulturore Artistike„ Sharri", e cila u themelua në kuadër të kolektivit tonë, që nga fillimi i punës së saj e deri më sot, ka arritur dhe po arrin vërtetë rezultate të mira dhe po arsyeton ekzistimin e vet.

Më se 50 anëtarët të kësaj shoqërie, që janë të inkuadruara në tri grupe: atë të folklorit, valltarëve dhe këngëve të melosit popullor,

[27] Shkrimin nga gazeta „Rilindja" e siguruam nga Remzi Ballazhi

[28] Sharri, gazetë informative e OPB „ Sharri" Hani i Elezit, të cilën e siguruam nga Liman Dernjani

gjatë aktivitetit të tyre, treguan një angazhim të madh duke dhënë koncerte jo vetëm para punëtorëve të ,,Sharrit", por edhe në komunë dhe qytete tjera në krahinë.
Është për çdo lëvdatë pjesëmarrja e tyre në festivalin e Gllogovcit dhe Suharekës. Siç na tha njëra ndër veteranët e kësaj shoqërie dhe këngëtare tani e njohur - Shegë – Berisha, prezantimi i shoqërisë kudo që ishte, u pranua me kënaqësi dhe duartrokitje frenetike.
Sa i përket kushteve të kësaj shoqërie, mund të themi se ato ekzistojnë si të mira, por ka edhe ca halle.
Ja se çka thotë anëtarja e kësaj shoqja Shegë:
" Një numër bukur i madh i anëtarëve të shoqërisë sonë, tani e shumë vjet nuk janë të punësuar edhe pse me punën dhe angazhimin e tyre, shërbejnë si shembull i mirë për të gjithë ne. Ata, njëherit edhe banojnë nëpër fshatrat e ndryshëm të Hanit të Elezit dhe ju nevojitet që gjatë ditëve të provave të udhëtojnë edhe me disa kilometra. Kishte me qenë mirë, që të shqyrtohen mundësitë për punësimin e këtyre anëtarëve"
Në pyetjen tonë se ka edhe ndonjë problem që meriton të theksohet, shoqja Shegë u përgjigj:
,, Mendoj se është më se i nevojshëm bashkëpunimi edhe më i gjerë në mes shoqërisë sonë dhe BVI – së për kulturë në Kaçanik. Bashkëpunim, i cili do jepte qasje, impulse, rezultat, dhe suksese edhe më të mëdha".
Se për këto halle vërtetë është mirë të diskutohet më shumë se deri më tani, e arsyeton siç thamë edhe më lartë puna dhe suksesi i tyre i pamohueshëm. Sa për ilustrim po përmendim suksesin e fundit të tyre në garat komunale, ku këta të rinj, arritën të zënë vendin e parë dhe kështu ata përfaqësuan këto ditë komunën tonë në garat krahinore dhe ata me plotë sukses.

Të përfundojmë: shoqëria e „Sharrit", është mjaft aktive dhe puna e tyre frytdhënëse. Sukseset e arritura janë prezentë, por njëherit edhe obliguese për punë edhe më të mirë. Për këtë punë, mendojmë se është edhe e nevojshme, që ne të gjithë në rend të parë punëtorët e „Sharrit", të kemi një mirëkuptim edhe më të madh për hallet dhe problemet e tyre, të cilat, njëherit janë edhe të tonat.

E njëjta gazetë[29], por një vit më vonë, pra në vitin 1978 për suksesin e SHKA „Sharri" ndër të tjera shkruan:

„...Punëtori përditë e më tepër po bëhet krijues aktiv i vlerave artistike dhe jo soditës pasiv i tyre. Në të mirë të kësaj flet veprimtaria e begatshme dhe e nduarnduarshme e dy SHKA „ Sharri " dhe „ Bashkimi"(e fabrikës Lepenci vj) të cilat ndonëse nuk kanë kaluar më shumë se tre vjet, me sukses po arrijnë të zhvillojnë jetën kulturale zbavitëse. Si të reja, në gjirin e tyre kanë përfshirë nga 40 anëtarë aktivë. Amatorët e Hanit të Elezit, me sukses arritën të formojnë një orkestër homogjen dhe të përgatisin një koncert të pasur me këngë e valle burimore. Të dyja këto shoqëri me programet e tyre u prezantuan para punonjësve të kolektivit të tyre dhe nuk e teprojmë nëse themi se ngazëllyen publikun..."

Xhevat Shkreta, kujton

Anëtar i SHKA„Sharri" jam nga viti 1980. Kjo Shoqëri në kuadër të aktivitetit të saj ka pasur shumë aktiv edhe grupin e valleve dhe në çdo program jemi paraqitur me valle të cilat janë mirëpritur nga artdashësit. Për një kohë jemi „harrnuar" vetë me valle, por më vonë angazhuam koreografin e mirënjohur nga Shkupi Emin Gaxhën, një koreograf i rreptë dhe nga anëtarët kërkonte disiplinë. Pas Emin Gaxhës, si koreograf pranë Shoqërisë ka vepruar

[29] Gazeta informative e OPB „Sharri" Hani i Elezit e datës 4.7.1978, fq.6

Metush Axhami, por kontributin tonë e kemi dhënë edhe unë e Minir Luri, kujton ai.
Në skenë jemi paraqitur me këto valle:

- Vallja ,,Këllëqi" me koreografi të kombinuar në kohëzgjatje prej 7 minutave,
- Vallja e punëtorit, në kohëzgjatje prej 5 minutave,
- Vallja e Shotës,
- Vallja e Rugovës,
- Vallja e Gjilanit,
- Memetja, etj, kujton Xhevat Shkreta.

Gjatë kësaj periudhe të aktivitetit, rrëfen Shaban Rogaqi, SHKA,,Sharri" ushtrimet i mbante në Shtëpinë e të vetmuarve dhe ishin të rregullta. I palodhshëm ishte kryetari i kësaj Shoqërie Faruk Daci, por gjithsesi duhet vlerësuar edhe angazhimin e anëtarëve të tjerë të kryesisë si: Adem Shkreta, Llukman Vila, tani i ndjerë, Nexhmedin Daci, Aqif Hoxha, Halil Dardhishta, Naim Axhami, etj, të cilët bënin gjithçka që suksesi të mos mungonte. Udhëtimi nëpër koncerte realizohej me autobusin e kombinatit ,, Sharr". Shoqëria ishte e pajisur me veshje kombëtare si dhe me instrumente muzikore, thotë ai.

Shoqëria Kulturore Artistike,, Sharri", viteve të 80-ta ishte tejet aktive dhe mori pjesë në shumë KONCERTE si në: Han të Elezit, Kaçanik, Ferizaj, Mitrovicë, Prishtinë, Kumanovë, Shkup, Skënderaj, Pozhoran, Viti e Drenas dhe në këto FESTIVALE si në : Suharekë, Gllogovc (Drenas), Mitrovicë, Gjilan e Kaçanik

- Në festivalin e Suharekës, mori vendin e parë me këngën duet: Mori cucë syzezë, kënduar nga Shaban Rogaqi e Shengyle Berisha,
- Në festivalin e Gjilanit, si shoqëri mori vendin e parë,

- Në festivalin e Kaçanikut, mori dy herë vendin e parë, ndërsa Shaban Rogaqi mori plaketën e artë gjithashtu edhe Shengyle Berisha,
- Në vitin 1985 kanë përfaqësuar Kosovën në festivalin e Mitrovicës, ku kanë marrë pjesë shoqëri nga të gjitha republikat e ish Jugosllavisë, dhe në kuadër të këtij Festivali ,,Sharri" mori vendin e dytë,
- Kuvendi komunal i Kaçanikut më 7.11.1986, SHKA ,,SHARRI'' i ndanë Plaketën e artë
- Kjo Shoqëri, në Revistën e Folklorit burimor në Gllogovc mori çmim të rëndësishëm, krahas kësaj në Festivalin e SHKA-ve të organizatave punuese që u mbajt në Suharekë, morën çmimin e parë si një prej Shoqërive më të organizuara dhe në këto Festivale shkëlqejnë Shaban Rogaqi e Shengyle Berisha.

Shoqëria Kulturore Artistike ,,Sharri", në rrugëtimin e saj, kishte edhe bashkëpunëtorë nga Shkupi, të cilët nuk kursyen djersën dhe mundin që kjo Shoqëri të arrinte rezultate të kënaqshme. Artistët të cilët disa ishin të rregullt, e disa vinin sipas nevojës dhe ftesës që ju bënte Shoqëria janë:

Nehat Curri, Nejazi Curri, Destan Kryeziu, Vëllezërit Aliu, Mirali Reçi, Emin Gaxha, Metush Axhami, Lumturie Axhami, Agim Kamishi, Ismailhakiu nga Nikishtani, Selajdin Miftari, Igballe Hoxha[30].

Këta artëdashës, në kuadër të SHKA,,Sharri'' pos që shkrinin djersën e tyre, për këtë Shoqëri amatore, sjellnin edhe përvojën e tyre muzikore, andaj komuna e Hanit të Elezit u është mirënjohëse për kontributin e tyre kulturor.

[30] Informatë nga Shaban Rogaqi, Ekrem Rogaqi e Shengyle Berisha

Nga Albumi fotografik i aktivitetit të SHKA „Sharri”
viteve të 80-ta

Shaban Rogaqi dhe grupi folklorik i SHKA „Sharri" gjatë një koncerti, përkatësisht festivale ku çmimet, shpërblimet, diplomat e mirënjohjet ishin të pakontestueshme

Grupi folklorik në skenë ku çiftelia e sharkia i këndonin Kosovës dhe bukurive të saj.

Koha matet me aktivitete, pjesë nga SHKA „Sharri", kujtime që nuk harrohen

Fotografi nga grupi i instrumentalistëve të SHKA „Sharri" i kryesuar nga harmonikisti Fadil Vila (i pari nga e djathta) të cilët nën tingujt e këtyre instrumentave, përcjellën këngët e bukura të solistëve të Shoqërisë.

Edhe një fotografi, si dëshmi e aktivitetit të Shoqërisë

Fotografi që flet. SHKA „Sharri" e udhëhequr nga Faruk Daci në mesin e tyre: Lumturie Axhami, Shengyle Berisha, Shaban Rogaqi, Ali Bushi, Ismet Kuka, Fadil Vila, vëllezërit Aliu, etj, të cilët patën shumë suksese në koncerte e festivale.

Shengyle Berisha dhe grupi gjatë një koncerti

Ismet Kuka, Xhevat Shkreta, Shaban Rogaqi, Muhamet Berisha, Llukman Vila, Sazana Brava, Naim Axhami

Valltarët e SHKA,,Sharri", fotografi e vitit 1986

SHKA,,Sharri" kishte aktiv grupin e valleve. Në çdo program , valltarët e Shoqërisë paraqiteshin me valle të ndryshme të cilat u mirëpritën nga artdashësit.

NË MESIN E AMATORËVE

AKTIVITETI KULTUROR STIMULON PUNËN PRODHUESE

Paraqitjet e amatorëve të shoqërisë kulturore-artistike «Sharri» të Hanit të Elezit kohëve të fundit bëjnë të shpresohet se do të rritet edhe më shumë aktiviteti i tyre.

Për të qëlluar një atmosferë edhe më të ngrohtë e më të kënaqshme në mesin e tyre, punonjësit e organizatës «Sharri» të Hanit të Elezit, para më shumë se dhjetë vjetësh, formuan shoqërinë kulturore-artistike, e cila gjithashtu mban emrin e organizatës së tyre. Në fillim u tubua një numër i caktuar entuziastësh, për t'u bërë sot rreth gjashtëdhjetë vetë nxënës e profesionistë të ndryshëm. Për të krijuar një lazet me të mirë në këtë mes, u ftuan edhe të rinjtë e të rejat e Hanit të Elezit për të dhënë kontributin e tyre në jetën kulturore-argëtuese të Bashkësisë së tyre. Lokale dhe më gjerë. Kështu pra, gradualisht u formua radhët e amatorëve dhe me forcat të përzgjedhëta mori vjeshtë të dilnin në skenë me vlerat e tyre interpretuese.

Hapat e fillimit, thonë amatorët e SHKA «Sharri», mund të marrin me mend se çfarë do të mund të kenë qenë, mirëpo, pastaj shoqëria u forcua dhe kështu fitoi një siguri e lirë më të madhe për të dalë me vlera

«Piskatës e artës të Kuvendit Komunal të Kaçanikut. Ky shpërblim gëzohet amatorët e SHKA «Sharri» do ti nxisë për një shkrimet më të dendur e të pakëputur, sepse ata sivjet nuk qenë aq aktivë. Por pro-

odhëtarët e organizatës punonjës, të cilët, siç thonë amatorët, interesohen vetëm para tubimit manifestimit e ose lanetit të rradhë, kanë pak a fare nuk u interesuar aktivitetet [illegible] tyre dhe i punonjësve të tyre do t'i pasurojnë programet e SHKA «Sharri» me «lëng të re», ndërsa lexuesit publicistë e fuqishëm dhe grupi i valëzave do të mund të jepnin më shumë për dashamirët e artit. Aktiviteti kulturor-argëtues do të stimulonte edhe më shumë punën prodhuese, sepse atëherë punonjësi e kthej mjedisin kurdo që janë shfaqur programe kanë pasur interesim. Ai

Faksimil nga një shkrim më i gjerë, i gazetarit Shyqri Galica, në gazetën „Rilindja" në vitin 1986 për SHKA„Sharri" të Hanit të Elezit

SHKA „SHARRI” 1990 -1999

Viti 1990 shënon rrënimin e të gjitha organeve autonome që kishte Kosova deri në këtë kohë. Si rezultat i kësaj, fillojnë reprezaljet dhe ndjekjet më të egra në të gjitha fushat, e në këtë rast, shkatërrohet edhe aktiviteti kulturor në trevën e Hanit të Elezit. Forcat policore serbe, krahas ndërhyrjeve në fushat tjera, ndërhyjnë edhe në Shtëpinë e kulturës ku marrin dhe shkatërrojnë veglat muzikore të SHKA „Sharri” dhe në bisedë informative marrin aktivistët e kësaj Shoqërie[31].

Djalëria dhe popullata shqiptare e kësaj ane, duke sfiduar një pushtim të tillë, ngritën sistemin e tyre mbijetues duke filluar

[31] Informatë nga Shaban Rogaqi, dhënë autorit më 29.12.2013, Hani i Elezit

nga partitë politike, mbijetesën e shkollës shqipe, solidaritetin ndërnjerëzor, sistemin informues e deri në zhvillimin e jetës kulturore, ku në vitin 1991 formohet grupi letrar ,,Luigj Gurakuqi"[32] , më pas Shoqëria kulturore ,, Ismail Qemali" si dhe u formua Liga komunale shumë e suksesshme me 14 ekipe garuese, Ligë e cila u formua në tetor të vitit 1994[33].

Gjurmëve të hulumtimit se kur u formua SHKA ,, Ismail Qemali" në Han të Elezit, shpalosëm revistën „Buletini" organ informativ i degës së LDK-së, ku në numrin 1 të janarit të vitit 1993, shkruan:

,, Me iniciativën e Forumit Rinor të Hanit të Elezit, javën e parë të janarit në këtë vit (1993), u formua SHKA ,,Ismail Qemali" e cila për fillim ka 15 anëtarë.[34]

Shkaqet që ndikuan në formimin e kësaj Shoqërie janë shkapërderdhja e pjesërishme e Shoqërisë ,,Sharri" pas ndërhyrjes policore serbe, e në anën tjetër nevoja për një riorganizim tjetër, në rrethana poashtu të tjera dhe vet emërtimi i Shoqërisë me emrin e Ismail Qemalit, flet mjaftë.

Kryetar i kësaj Shoqërie dhe themelues i saj ishte Rufki Suma dhe fillimisht kishte 15 anëtarë. Anëtarët e Shoqërisë, krahas të tjerëve, ishin edhe pjesëtarët e SHKA ,,Sharri" të cilët rigrupohen pranë kësaj Shoqërie, duke e ringritur aktivitetin muzikor dhe nga viti 1993 e deri në vitin 1997 sa veproi kjo Shoqëri kulturore, arriti të realizoj një numër të konsideruar të koncerteve, të cilët kishin edhe konotacionin tjetër atë të afrimit të popullatës, homogjenizimit të saj, mbajtjen e rinisë në aktivitet

[32] Shaban Çupi,, Veprimtaria poetike e grupit letrar ,,Luigj Gurakuqi" 1991-1993", vepër në dorëshkrim

[33] Buletini, viti V, gusht 1995, nr.2

[34] Buletini, viti III, nr.1 1993, organ informativ i Forumit Rinor në Han të Elezit

dhe sfidimin e shpërnguljes e cila në atë kohë ishte shqetësuese në tërë Kosovën.

Shoqëria Kulturore Artistike ,,Ismail Qemali", aktivitetin e saj e zhvilloi në objektin e shkollës fillore. Instrumentet muzikore të gjitha ishin private, ushtrimet ishin të rregullta dhe mobilizuese dhe arritën të japin shumë koncerte si në Han të Elezit, në fshatin Guranë, në fshatin Paldenicë, në fshatin Laç, dhe nëpër oda familjare, me një fjalë kudo që kishte mundësinë e shtrirjes së aktivitetit të saj.

Aktivitetin e kësaj Shoqërie, jo rrallë e ndërpriste ndërhyrja e policisë serbe, dëshmon Xhemil Brava, por pas ndërhyrjes, këmbëngulësia për zhvillimin e jetës kulturore ishte e pakontestueshme dhe kështu jeta vazhdonte derisa një ditë, instrumentet muzikore u zëvendësuan me armë, por është me rëndësi të themi se jeta kulturore nuk u ndërpre, ajo u zhvillua edhe gjatë luftës, brenda Brigadës 164,, Gafurr Loku" të UÇK-së në Puset e Nikës, kujton ai.

Në grupin e instrumentalistëve të SHKA ,,Ismail Qemali" bënin pjesë:

Xhemil Brava(harmonikë), Fevzi Rogaqi (çifteli), Nesim Curri (çifteli), Zelfi Rogaqi (sharki), Ismet Daci(çifteli), Rexhep Rogaqi (çifteli), Ibrahim Brava (çifteli), Ismet Shiti (lodër), Kadri Brava (çifteli), Sali Kuka (çifteli), Besim Rogaqi (kitarë), Ali Bushi (klarinet), Muharrem Rogaqi (violinë).

Këngëtarët që kënduan pranë kësaj Shoqërie:

Fatmir Hasallari, Nexhmedin Rexhallari, Naser Berisha, Mejreme Thaçi, Idajete Buçi, Zelihaje Hasallari, Havushe Buçi, Shpresa Axhami, Miqere Hasallari, Bedrije Bushi, Nesim Curri, Xhemil Brava, Fevzi Rogaqi, Ismet Daci, Esmire Dernjani, Xhavit Brava, Adem Brava, Nahije Thaçi, Besim Rogaqi.

Fotografi e datës 1.6.1993, ku në anën e pasme të kësaj fotografie është shkruar data e saj si dhe emrat e anëtarëve të kësaj Shoqërie: Rufki Suma, Ismet Shiti, Nesim Curri, Zelfi Rogaqi, Mejreme Thaçi, Idajete Buqi, Zilihije Hasallari, Naser Berisha, Nexhmedin Rexhallari, Ismet Daci, Kadri Brava, Shpresa Axhami, Fevzi Rogaqi, Fatmir Hasallari, Besim Rogaqi, Rexhep Rogaqi, Bedrije Bushi, Xhemil Brava, Mikereme Hasallari.

Krahas koncerteve të realizuara në trevën e Hanit të Elezit, kjo shoqëri në dy raste ka realizuar dy koncerte të përbashkëta në rrethinë të Tetovës në bashkëpunim me shoqërinë e fshatit Jazhicë.

Me fotografitë që arritën t`ju shpëtojnë flakëve të luftës, synojmë të faktografojmë veprimtarinë e saj, si një dëshmi për historikun e jetës kulturore në trevën e Hanit të Elezit.

Fotografi e vitit 1994, ku në anën e pasme të kësaj fotografie shkruan: 21.12.1994, Guranë, si dhe emrat në fotografi: Rufki Suma, Sali Kuka, Nesim Curri, Ibrahim Brava, Besim Rogaqi, Xhavit Brava, Adem Brava, Xhemil Brava, Havushe Buqi, Esmire Dernjani, Nahije Thaçi, Diana Dernjani.

Fotografi e datës 28.11.1997, ku njëherit është edhe koncerti i fundit i SHKA„Ismail Qemali" pasiqë rrethanat shkonin drejtë një lufte të pashmangshme

Fotografi e datës 21.12.1994, Guranë

Nesim Curri dhe grupi gjatë koncertit në Guranë si dhe Xhavit Brava, Nabije Thaçi e Xhemil Brava

Grupi i valleve i Shoqërisë i udhëhequr nga valltari Rabit Shkreta, në mesin e të cilëve janë edhe Shyrete Dernjani, Esmire Dernjani, Remzije Daci, Vlora Bela, Halim Shkreta, Mersel Imishti, Mevlud Brava, Sabaudin Shkreta, Diana Dernjani,etj.

SHKA „SHARRI” 1999- 2014

11 qershori i vitit 1999, shënon ditën e çlirimit të komunës së Hanit të Elezit nga pushtuesi serb. Lufta kishte sjellë dëme të mëdha, si në humbje njerëzish e gjithashtu edhe në të mirat materiale.

Megjithatë, rimëkëmbja e kësaj treve filloi menjëherë. Njerëzit e dëbuar me dhunë nga atdheu, u kthyen me shpejtësi në shtëpitë e tyre. U vu në jetë gjiganti i prodhimit, fabrika e çimentos „Sharr” dhe fabrikat e tjera në trevën tonë. Punëtorët iu kthyen punës e nxënësit mësimit. Krahas kësaj, kishte nevojë edhe për riaktivizimin e jetës kulturore dhe një detyrë e tillë iu caktua shkrimtarit Fadil Curri, i cili mblodhi anëtarët e Shoqërisë dhe

kështu filluan edhe koncertet e para pas çlirimit, duke filluar nga ai i Ditës së Flamurit më 28 nëntor 1999.

Kësaj Shoqërie, iu rikthyen anëtarët e vjetër dhe të rinj të cilët edhe në kohët më të vështira, nuk kishin hequr dorë nga zhvillimi i jetës kulturore. Këtë detyrë , si kryetar i Shoqërisë, Fadil Curri e ushtron deri në vitin 2001, ku emërohet si Drejtor i shtëpisë së kulturës „Xheladin Kurtaj" në komunën e Kaçanikut. Gjatë kësaj kohe krahas të tjerave u realizua edhe kënga për dëshmorët Gafurr e Driton Loku me tekst të Fadil Currit dhe e kënduar nga Avni Bushi. Për të pasqyruar me detajisht, periudhën e pasluftës dhe zhvillimin e jetës kulturore në këtë trevë, për monografinë e SHKA„Sharri" sjellim shkrimin e shkrimtarit të palodhshëm të kësaj treve Fadil Currit.

Fadil Curri, kujton

Edhe Hani i Elezit me rrethinë nuk u kursye nga lufta. Pos që ishte skele e fundit për largim nga „ ferri'', edhe vdekjet e njerëzve nuk ishin të pakta nga gjakpirësia e armikut. Dëgjoja nënat e familjarëve të mi si rrëfenin për çastet e fundit të jetës me bijtë e tyre të vrarë e të zhdukur në luftë. Ishin çaste prekëse, por krenari që edhe kjo anë kishte bërë flijime për Kosovën. Dashamirët e lirisë dhe të demokracisë, të shërimit të pasojave të luftës, të zhvillimit të Kosovës, të bërjes shtet sa më parë, në Han të Elezit u organizuan rreth qeverisë komunale lokale të Hanit të Elezit, shtrirje e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës së pasluftës, për të krijuar dikasteret pushtetore, sektorët komunalë. Më ra hise të jem udhëheqës i sektorit për kulturë në kuadër të njërës nga drejtoritë gjegjëse. Ndër pikësynimet ishte edhe riaktivizimi i Shoqërisë Kulturore-Artistike "Sharri" në Han të Elezit. Pas nja 2 takimesh, anëtarët e saj vendosën të më vënë në krye të kësaj SHKA-je. E pranova edhe për arsyen që të neutralizoj ambiciet e klaneve të

shfaqura. Të dyja palët u pajtuan të jem kryetar i SHKA "Sharri" edhe nga arsyeja se edhe para luftës e kisha përcjell veprimtarinë e saj dhe kisha njohuri kulturore të përgjithshme rreth nocionit kulturë. Me rëndësi ishte ngjallja kulturore në Han të Elezit e kudo që kishim mundësi. Më kujtohet se organizimin e parë e kishim gjatë 28 Nëntorit të parë, Ditës së Shqiptarisë, kur këtë ngjarje e shënuam me orë letrare, recitale të inskenuara dramatikisht, ekspozitë pikturash nga piktorët e rinj të këtushëm, mini-panair të librit në njërën nga kafenetë e këtushme, ne shkollën fillore të këtushme bëmë edhe orën letrare dhe takimin me piktorin e njohur ndërkombëtarisht, Adem Kastrati, i cili edhe ia fali një pikturë të tij përfaqësuesit të KFOR-it në shenjë falënderimi për ndihmën ushtarake e të sigurisë në Kosovë, takim me kryetarin e shkrimtarëve shqiptarë në Maqedoni. Jeta letrare e Kosovës nisi pikërisht në Han të Elezit, kur u botua romani i parë në Kosovën e pasluftës (fillim i vitit 2000) me autor nga Hani i Elezit(Fadil Curri, plotësim i Shaban Çupit), e më pastaj panë dritë edhe libra të tjerë me tematikë luftarake-çlirimtare nga autorët hanelezas. Për herë të parë në Han të Elezit u organizua edhe ora letrare e "Karvanit të Shkrimtarëve" me Rifat Kukajn, Agim Devën, Zejnullah Halilin e shkrimtarë të tjerë. Shumë organizime të këtushme i emituan radiotelevizione nga Maqedonia. Nga kjo kohë ishte edhe protesta e organizuar pas vrasjes së fshatarëve të Kryenikut dhe gazetarit britanik, Lejton. Meqë në vitin 2001 u desh të shkoj drejtor për Kulturë, Rini e Sport në Kaçanik, për shkak të konfliktit të interesit u desh të pushoj nga kryetarllëku në SHKA "Sharri". Gjatë vakuumit deri në zgjedhje të Kryesisë së re, kuturën në Han të Elezit e kisha preokupim zhvillimor. Për herë të parë pas luftës në sallën e ish-kinemasë dha koncert SHKA nga Nerezi i Shkupit, pastaj u bë

defilimi i SHKA "Valët e Liqenit" të Ladorishtit të Strugës, koncerti i një shoqërie nga Kaçaniku i Vjetër e të tjera që nuk po më kujtohen hëpërhë. U vërejt ngjallje e publikut për koncerte, poezi, dramë ("Pajtimi më 28 Nëntor" u shfaq, me aktorë, regji e autor teksti të këtushëm). Këtë kohë edhe kursi i pikturës u hap në kuadër të Qendrës Rinore, të themeluar dhe financuar pas luftës. Duhet përmendur se pos shkollarëve të këtushëm, kontribut të madh dhanë artistët e kësaj ane, si vëllezërit Rrogaçi, Avni Bushi, sidomos pedagogët e kulturës, Nejazi Dernjani e Bukurie Shkreta. Ishte një kohë e pasluftës, kur plagët e luftës donim t'i shëronim përmes kulturës, kohë kur donim të nderonim gjakun e dëshmorëve, kontributin e luftëtarëve pjesëmarrës në çlirimin e vendit dhe sakrificën e pashoqe të popullit tonë me decenie e shekuj deri në çlirimin e vendit. Ishte kohë kur punonim pa orar, vetëm e vetëm të përjetojmë fytyrat e lumturuara të njerëzve hallemëdhenj, të traumatizuar nga lufta, kohë kur donim të kthenim ngushëllimin në shpresë se do të vijë ditë më të mira për popullin shqiptar.

Avni Bushi, kujton

Në vitin 1999 jam anëtarësuar në Shoqërinë Kulturore Artistike „Sharri" dhe në atë kohë ishte vështirë të zhvilloheshin aktivitetet kulturore sepse mungonin edhe kushtet elementare për zhvillimin e aktiviteteve.

Aktivitetet e para në Shoqërinë kulturore artistike „ Sharri'' pas luftës i kam zhvilluar me Shaban Rogaqin, Muharrem Rogaqin, Fevzi Rogaqin, Ekrem Rogaqin, Sefer Rogaqin, Besim Rogaqin, Ramadan Rogaqin, Ismet Shyti, Xhemil Brava, Xhavit Brava, Fadil Brava, Adem Brava, Havushe

Daci, Nesim Curri, Hajrije Bushi, Kimete Kuka, Selime Rexha, Sali Kuka, Alban Laçi, Shefket Beça, Ismet Daci, Misim Tuqi, Bidajet Kalisi, Ramiz Hasallari, Faredin Luma. Në Shoqërinë kulturore artistike „Sharri'' vazhdimisht kanë ardhur edhe kuadro të tjerë duke filluar nga valltarët, instrumentalistë, solistë, folkloristët, kujton ai.

Gjatë kësaj periudhe, kryetar i Shoqërisë u zgjodh Fadil Curri, ndërsa pas tij vjen Rexhep Shkreta, ndërsa pas tij, Sherif Berisha dhe gjatë kësaj periudhe Shoqëria Kulturore Artistike „Sharri" arrin të stabilizoj grupin e instrumentalistëve, grupin e folklorit dhe atë të valleve dhe arritën që të shfaqin koncerte gjatë manifestimeve përkujtimore të pasluftës dhe festave kombëtare e ndërkombëtare, koncerte të cilat u mirëpritën nga artdashësit e komunës së Hanit të Elezit.

Rexhep Shkreta, kujton

Nevoja për zhvillimin e kulturës, nevoja për të shënuar datat e rëndësishme nga historia jonë, bënë që të pranoja edhe detyrën e kryetarit të Shoqërisë. Kryetar i SHKA„Sharri'' zgjedhem me datën 1.8.2001 dhe menjëherë filluam punën.

Si çdo Shoqëri tjetër, edhe Shoqëria jonë kishte nevojë për gjithçka, duke filluar nga instrumentet muzikore, veshjet kombëtare, zërimin, mikrofonat e gjërat e tjera përcjellëse. Duke iu falënderuar donatorëve si qeverisjes komunale të pasluftës, pastaj „Salonitit'' „Krasit'', „Lurit'', Mirsad Kukës, Vëllezërve Rogaqi si dhe Nuredin Çupit ne siguruam mjete në vlerë prej 9510 markave gjermane dhe zhvilluam një numër të konsiderueshëm aktivitetesh.

Anëtarët e Shoqërisë ishin aktivë dhe kishin dëshirë të shfaqnin artin e tyre. Gjatë kësaj periudhe ishin aktiv grupi i

instrumentalistëve, folklorit dhe ai i valleve dhe çdo herë që dhamë koncerte, ata u mirëpritën nga qytetarët.

Një ndër sukseset që ia vlen të përmendim gjatë kësaj periudhe sa isha udhëheqës i saj është edhe viti 2002 ku krahas koncerteve që dhamë në Han të Elezit , në vitin 2002 morëm pjesë dhe arritëm sukses meritor në Revistën e SHKA komunale që organizoheshin në Kaçanik. Nga angazhimi që kisha në sfera tjera të jetës, më 25.6.2003, dhashë dorëheqje nga posti i kryetarit të shoqërisë, dhe në vendin tim u zgjodh Sherif Berisha.

Sherif Berisha, kujton

Kryetar i Shoqërisë u zgjodha pas dorëheqjes së Rexhep Shkretës, në qershorin e vitit 2003, por përkundër dorëheqjes së tij , Rexhep Shkreta aktivitetin e tij e vazhdon në kuadër të Kryesisë deri në shtatorin e vitit 2005.

Gjatë kësaj periudhe, Shoqëria kulturore artistike „ Sharri" për të ngritur edhe më tej nivelin artistik, kishte nevojë për ngritje profesionale të valleve, andaj në këtë drejtim u angazhua koreografja nga Shkupi Lulëzime Hamidi[35] e shoqëruar dhe nga Besim Ramadani.

Nga koreografja Lulëzime, Shoqëria u pasurua edhe me një numër të caktuar vallesh dhe valltarët që mund t`i kujtoj gjatë atyre viteve ishin: Sabaudin Shkreta, Isuf Shiti, Rufat Shkreta, Selver Shkreta, Nureman Kalisi, Setki Kalisi, Suad Luri si dhe grupi i vajzave valltare në mesin e tyre edhe Samije Dernjani. Më kujtohet edhe fakti tjetër se pas Lulëzime Hamidit grupin e valleve e ka udhëhequr Suad Luri[36]. Nga solistët kujtoj: Shaban Rogaqi, Adem Brava, Sadije Bushi, Abetare Bushi, Venore Vila, Shefket Beqa, Avni Bushi, Arlinda Gashi, Havushe Loku,

[35] Informatë nga Rexhep Shkreta dhënë autorit më 15.2.2014, Hani i Elezit
[36] Informatë nga Sherif Berisha dhënë autorit më 15.2.2014, Hani i Elezit

Gazmend Bushi, Isa Rexhallari, Berat Rexhallari, Nexhmedin Rexhallari, etj. Instrumentalistët e kësaj Shoqërie ishin: Muharrem Rogaqi, Fadil Vila, Ramadan Rogaqi, Ekrem Rogaqi, Sefer Rogaqi, Alban Laçi, Nejazi Dernjani, Nuredin Çupi, Xhemil Brava, Ismet Shiti, Bashkim Bushi, Burhan Bushi, Faredin Luma, Ilir Krasniqi, etj.

SHKA,,Sharri" gjatë viteve 2002- 2003

SHKA,,Sharri" në Vlorë, shtator 2005

„Sharri" në skenë në festivalin e Vlorës, shtator 2005

SHKA„Sharri" në festivalin e Sarandës, 2007

Iliriana Daci, gjatë interpretimit të rolit kryesor në vallen koreografike ,,Lirinë s`ta falë kush" si dhe Sevime Bushi në vallen ,,Shamia e kuqe na bashkoi"

Nejazi Dernjani, kujton

Anëtarë i SHKA„Sharri" jam nga vitit 1980. Kam kaluar pothuajse nëpër të gjitha fazat e zhvillimit të kësaj Shoqërie. Kam mbërri gjeneratën e viteve të 70-ta, por aktiviteti im është nga viti 1980. SHKA„Sharri" kishte shumë suksese viteve të 80-ta, por s`mungoi angazhimi edhe në dekadën e mëpasme. Pas lufte u bë riaktivizimi i Shoqërisë. Në vitin 2002 isha udhëheqës i grupit folklorik të SHKA„Sharri" dhe pos meje ky grup kishte këta anëtarë: Nuredin Çupi, Alban Laçi, Bashkim Bushi, Shefket Beqa, Burhan Bushi, Sokol Loku, Muhamet Bushi, Muhamet Daci, Xhemali Thaçi, Ramadan Rogaqi, etj. Në muajin prill 2002, në Kaçanik u mbajt Revista e SHKA komunale dhe në këtë Revistë, SHKA„Sharri" mori vendin e parë dhe njëherit përfaqësoi Kaçanikun në Festivalin Mbarëkombëtarë të SHKA dhe Ansambleve „ Kaçaniku 2002" i cili u mbajt më 11 qershor të atij viti. Në këtë festival morëm pjesë vetëm me orkestrinën e folklorit dhe solistët që morën pjesë ishin motrat Hajrije e Besiana Bushi, Avni Bushi, Venore Vila, Shefket Beça. Nga juria profesionale: Rexhep Munishi, Engjëll Berisha e Tefik Shehu, Shefket Beça shpallet solisti më i mirë i natës së parë. Nga viti 2005, arritëm që niveli artistik i kësaj Shoqërie, të ngritet edhe më tepër. Realizuam këngë e valle origjinale dhe ishim tejet aktiv nëpër të gjitha festivalet duke filluar nga vitit 2005, 2006, 2007, 2008, 2009. Morëm shumë çmime, Mirënjohje e Diploma. Gjatë tërë kësaj kohe kam qenë udhëheqës artistik i SHKA„Sharri'.

Nuredin Çupi, kujton

Në vitin 2005, pas festivalit të Kaçanikut, në kontakt me Deli Metaliajn dhe Skënder Doshlanin, biseduam për koreografinë e një valleje dhe u dakorduam që të realizohet ajo, por paraprakisht u ftuam që të marrim pjesë në „ Sofra dardane 2005". Pasi e realizuam „ Sofrën dardane 2005'' dhe morëm çmimin e parë për

valle instrumentale, në shtatorin e vitit 2005 marrim ftesë për festivalin e Vlorës të cilin edhe e realizojmë. Pas festivalit të Vlorës, unë dhe Nejazi Dernjani shkuam në qytetin e Bajram Currit dhe u dakorduam për çmimin e dy valleve „ Qëndresë dardane" dhe ,,Lulëkuqet e Kosovës'' që të realizohen për festën e 28 nëntorit 2005. Koreografi Deli Metaliaj dhe kompozitori Skënder Doshlani, në tetor të vitit 2005, filluan punën me anëtarët e SHKA,,Sharri" dhe realizuan dy vallet e lartcekura. 50% të këtij projekti, materialisht i realizova unë, ndërsa të tjerat nga donatorët vendor. SHKA,,Sharri" për festën e flamurit, më 28 nëntor 2005, dha një koncert ku u përfshinë edhe vallet e reja: Qëndresë dardane, Shamia e kuqe na bashkoi dhe Lulëkuqet e Kosovës, si dhe kënga për dëshmorin Gafurr Loku të cilën e këndoi Nesim Curri. Ky koncert u mirëprit nga shikuesit sepse vallet e reja dhe këngët ishin origjinale dhe avancimi artistik i Shoqërisë mori kahjen e dëshiruar. Më kujtohet se gjatë këtij koncerti me një fjalë rasti para të pranishmëve u paraqit edhe Deli Metaliaj, ndërsa Skënder Doshlani këtë koncert e ka shoqëruar me harmonikën e tij. Gjithashtu vlen të theksohet se në këtë koncert lodragji kemi pasur Nehat Currin nga Shkupi. SHKA,,Sharri" suksesin e vitit 2005 e ka bartur edhe katër vite më pas në koncerte e festivale, dhe si rezultat i punës së pamohueshme arritëm që të marrim shumë çmime jo vetëm në Kosovë, por edhe jashtë saje. Nga shumë kujtimet që kam rreth aktivitetit tim në këtë Shoqëri, do ta veçoja Festivalin e Sarandës, në të cilin festival ne u paraqitëm me vallen koreografike,, Lirinë s`ta falë kush" dhe jo vetëm që kjo valle mori çmimin e parë, por ajo u përjetua edhe emocionalisht nga publiku. Kjo valle jo vetëm që pasqyronte dëbimin biblik të popullatës së Kosovës, por fat të njëjtë kishte edhe popullata çame. Gjatë këtyre viteve Shoqëria ka

pasur një grup folklorik shumë të organizuar si dhe valltarë që me përkushtim iu rrekën punës si dhe këngëtarë të cilët sollën freski dhe origjinalitet në skenën tonë, kujton ai.

Valltarja Sevime Bushi dhe Nexhmedin Shkreta, dy valltar të spikatur të SHKA„Sharri" të cilët shkëlqyen në koncertin e 28 nëntorit 2005 dhe jo vetëm të tij

Pjesë nga vallja koreografike ,, Qëndresë dardane" e realizuar për herë të parë më 28.11.2005

Nexhmedin Shkreta e Sevime Bushi gjatë ekzekutimit të valles koreografike ,,Shamia e kuqe na bashkoi''

Pjesë nga vallja koreografike ,, Lulëkuqet e Kosovës"

Solistët : Shefket Beça, Adem Brava e Nesim Curri, 2005

Pjesë nga Grupi i valltarëve; Avni Thaçi, Enver Thaçi, Jasir Daci, Erkan Bela e Agim Dernjani, në vitin 2007.

Nga procesverbalet e mbledhjeve

Nga një procesverbali i datës 8.12.2005 i SHKA,,Sharri", kuptojmë se Kryesia ka mbajtur një mbledhje me këtë rend dite:

1. Zgjedhja e kryesisë
2. Të ndryshme

Në këtë procesverbal më tej thuhet se Zgjedhja e kryesisë u bë në prani të gjithë anëtarëve të grupit të valleve, orkestrës, etj, ndërsa kryetar i Shoqërisë u zgjodh me shumicë votash Nejazi Dernjani.
Në mbledhjen tjetër të kryesisë e cila mbahet me datën 5.1.2006 e cila kishte tri pikë të rendit të ditës:
1. Dorëheqja e kryetarit
2. Zgjedhja e kryetarit
3. Të ndryshme

Thuhet se përshkak të ngarkesës në punë, kryetari i deritanishëm Nejazi Dernjani jep dorëheqje sepse ushtron dy poste dhe nuk mund të arrijë që të kryej edhe punën e kryetarit.
Në pikën e dytë të rendit të ditës, pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetar i SHKA,,Sharri'' u zgjodh Mehmet Ballazhi, nënkryetar u zgjodh Alban Laçi, ndërsa sekretare e Shoqërisë u zgjodh Iliriana Daci. Po në këtë mbledhje si përgjegjëse e valltareve u caktua Sevime Bushi, ndërsa i valltarëve Nexhmedin Shkreta.
Në një procesverbal tjetër të Shoqërisë i datës 18.2.2006, kryesia e Shoqërisë vendos që të ndanë Mirënjohje për angazhim këtyre anëtarëve:

1. Nexhmedin Shkreta, valltar
2. Nexhat Thaçi, valltar
3. Sevime Bushi, valltare
4. Sevime Laçi, valltare
5. Shefket Beça, solist
6. Sefedin Thaçi, valltar

7. Xhevahir Dernjani, valltar
8. Haki Curri, valltar
9. Fatlume Dernjani, valltare
10. Qëndresa Dernjani, valltare
11. Alban Laçi, instrumentalist
12. Iliriana Daci, valltare

Krahas këtyre vendimeve, po në këtë mbledhje u diskutua edhe për angazhim të mëtejmë në ngritjen cilësore të Shoqërisë.
Në procesverbalin e datës 2.3.2006 thuhet se janë marrë të gjitha masat për koncertin i cili do të mbahet në Tetovë më 2 mars 2006 dhe se janë siguruar mjetet e nevojshme për koncertin. Në këtë koncert, krahas Shoqërisë Sharri, me një kërcim nga zona e Gashit dhe Krasniqes do të paraqiten Deli Metaliaj dhe Skifter Doqi.
Në procesverbalin e datës 20.3.2006 thuhet se në bashkëpunim me shkollën fillore „ Ilaz Thaçi" janë zgjedhur një numër i konsiderueshëm nxënësish për t`u anëtarësuar si anëtarë të rinj të Shoqërisë.
U regjistruan rreth katër dhjetë vajza e tridhjetë djem dhe përzgjedhjen e tyre e ka bërë koreografi Deli Metaliaj. Po në këtë mbledhje thuhet se një kërkesë ka ardhur nga fshati Kotlinë që Shoqëria „ Sharri'' të merr pjesë në manifestimin që mbahet për dëshmorët e këtij fshati me datën 24.3.2006.
Në procesverbalin e datës 21.3.2006, thuhet se janë bërë provat e para me grupin e anëtarëve të rinj dhe ushtrimet janë udhëhequr nga Nexhmedin Shkreta e Sevime Bushi.
Në procesverbalin e datës 24.3.2006 thuhet se Shoqëria ka marrë pjesë në manifestimin e dëshmorëve të fshatit Kotlinë me vallen koreografike „ Qëndresë dardane", ndërsa më 29 mars 2006 ka

marrë pjesë në shënimin e pesë vjetorit të rënies së dëshmorëve në fshatin Kryenik me këto pika:
Vallen,, Lulëkuqet e Kosovës''
Vallen ,,Qëndresë dardane"
Këngën ,, N`kullë t` Shabanit"
Këngë për dëshmorin Gafurr Loku
Në procesverbalin e datës 10.4.2006 thuhet se është arritur marrëveshja për një koncert në qytetin e Gostivariti i cili do të mbahet me 28 prill 2006 në shtëpinë e kulturës. Për mbajtjen e këtij koncerti janë angazhuar Metali Bardhi, Nesim Curri dhe kryetari i komunës së Gostivarit Nevzat Bejta i cila na ka mundësuar që salla të jetë pa pagesë.
Në procesverbalin e datës 5.5.2006 thuhet se janë marrë të gjitha masat për manifestimin e 11 qershorit – Ditës së çlirimit të komunës së Hanit të Elezit dhe në këtë manifestim SHKA,, Sharri" do të shfaqë program rreth 50 minuta. Gjithashtu në këtë mbledhje u morën vendimet për pjesëmarrje në ,, Sofra dardane 2006" në Bajram Curr të Shqipërisë.
Në procesverbalin e datës 10.5.2006 thuhet se u mbajt festivali i folklorit ,, Anadrinia jehon'' në Dej të Rahovecit ku morëm pjesë me këto pika:
Brava-Bajrami, vallen koreografike Shamia e kuqe na bashkoi, këngë për dëshmorin Gafurr Loku si dhe tablon koreografike ,, Qëndresë dardane''
SHKA,,Sharri" shpallet Shoqëria më e mirë dhe mori vendin e parë.
Më 11.5.2006, Shoqëria ,,Sharri'' mori pjesë në Brod, me rastin e shpalosjes së përmendores së dëshmorit Ahmet Kaçiku.

Me 12.5.2006 Shoqëria ,,Sharri'' mori pjesë në festivalin „ Hasi jehon" ku dueti koreografik Nexhmedin Shkreta – Sevime Bushi u shpall dueti më i mirë.
Më 22.5.2006 Shoqëria ,,Sharri'' mori pjesë në fshatin Gllobocicë në shtatë vjetorin e rënies së dëshmorit Avdylgafurr Luma.
Më 25.5.2006 Shoqëria ,,Sharri'' u ftua që të merr pjesë në Dubravë të Kaçanikut me rastin e Ditës së Shkollës ,,Kadri Zeka"
Më 6.6.2006 Shoqëria ,,Sharri'' ftohet që të merr pjesë në festivalin „ I këndojmë lirisë" i cili mbahet në Klinë për nderë të dëshmorit Mujë Krasniqi.
Në procesverbalin e radhës të datës 7.6.2006 thuhet se janë bërë të gjitha përgatitjet për të marrë pjesë në Ditën e çlirimit të komunës dhe në këtë manifestim për herë të parë do të paraqiten edhe grupi i të rinjve.
Një procesverbal tjetër i datës 16.6.2006 thuhet se Shoqëria ,,Sharri'' mori pjesë në festivalin „ Sofra dardane" prej nga u kthyem me çmimin e parë.
Në procesverbalin e datës 29.8.2006 shënohet edhe manifestimi për nderë të Ditës së Dëshmorëve në Puset e Nikës, ku kjo Shoqëri u shfaq me programin e sajë.
Në një procesverbal tjetër të majit 2008, thuhet se në festivalin ,,Anadrinia jehon'' i cili u mbajt në Dej të Rahovecit, SHKA„Sharri" mori çmimin e parë Lahutën e festivalit..
Nga këto procesverbale që arritëm t`i gjejmë në arkivin e Shoqërisë, kuptojmë se SHKA„Sharri" ishte mjaftë aktive, kishte arritur që të korr një varg rezultatesh në festivale të ndryshme dhe në hapësirën shqiptare kishte arritur të ketë emër të merituesshëm.
Është me rëndësi të përmendet edhe një koncert i përbashkët në mes Shoqërisë ,,Sharri'' dhe Ansamblit ,,Dardania" të Tropojës i cili u mirëprit nga qytetarët e komunës së Hanit të Elezit. Nga

Ansambli „Tropoja” krahas Deli Metaliajt e Skënder Doshlanit morën pjesë me këngë e valle edhe: Pranvera Vatoci, Marien Qelia, Januz Milushi.

Objektiv i çdo Shoqërie Kulturore Artistike, krahas rezultateve në koncerte e festival, është edhe paraqitja mediatike, qoftë në mediat e shkruara, qoftë në mediat elektronike, të cilin objektiv kjo Shoqëri e realizoi në vitin 2006.

SHKA„ Sharri” në rrjedhë të aktivitetit dhe pas çmimeve që merrte në Festivale të ndryshme, arriti që si Shoqëri të bëj një inçizim në Radioteleivizionin maqedonas, programi në gjuhën shqipe, i cili edhe u realizua, fal edhe kontributit të zv.drejtorit të këtij institucioni z. Nazif Bushit. SHKA „Sharri’’ incizoi një program 30 minutësh, program i cili ka mbetur si dëshmi në arkivin e këtij medium.

Krahas kësaj, SHKA„Sharri” ishte prezent edhe në mediat tjera elektronike si dhe ato të shkruara, ditore e javore, kështu që prezantimi mediatik i aktivitetit të kësaj Shoqërie, mund të themi se ishte i kënaqshëm.

Kompozitori Skender Doshlani dhe udhëheqësi artistik i Shoqërisë, Nejazi Dernjani. Skënder Doshlani një herit ishte edhe kompozitori i këngës për dëshmorin Gafurr Loku

Koreografi Deli Metaliaj nga qyteti i Bajram Currit, meritor i padiskutueshëm për suksesin e SHKA ,,Sharri" në festivale nga periudha 2005-2009. Nga shkolla e tij artistike, dolën një numër i konsiderueshëm valltarësh të cilët edhe sot (2014), vallet e mësuara në vitin 2005 ua përcjellin grupeve të reja të valltarëve.

Derisa po hartoja monografinë e Shoqërisë, në rrjetin social Facebook, shfaqa fotografinë e koreografit Deli Metaliaj dhe në

komentimin e kësaj fotografie, shkruan shumë qytetarë, nga të cilët po veçoj vetëm disa:

Fadil Curri, shkrimtar e publicist i kësaj treve shkruan:

Ata që kuptojnë dhe ndjejnë artin e shkathtësinë e valles, metaforen e saj, duhet të jenë të lumtur nga prodhimi i këtij artisti që la vulë të pashlyeshme edhe në skenën e Hanit të Elezit. Pata fatin që me disa shkrimtarë të jashtë Hanit të Elezit, në skenën e komunës sonë t`i ndjekim disa valle nga vocërrakët dhe të rinjtë tanë dhe u bindëm se përvoja e dija e këtij heroi të valles e kishte bërë të veten pozitivisht.

Enver Thaçi, njëri nga nxënësit e tij shkruan:

Është nder dhe respekt për ne, që me vallet koreografike na bëri pjesë dhe pjesëmarrës në shumë festivale kombëtare. I gjithë suksesi ynë është merita jote prof. i nderuar.

Sevime Laçi, valltare e Shoqërisë „Sharri" shkruan:

Kam nder ta përshëndes edhe unë koreografin e mirënjohur Deli Metaliaj i cili ka kontribuar për trevën tonë. I uroj fat, shëndet, mbarësi dhe suksese.

Nuredin Çupi, shkruan:

Koreografin Deli Metaliaj e kompozitorin Skënder Doshlanin i kemi miq shtëpie. Ata ngritën në nivel shkencor kulturën në komunën e Hanit të Elezit. Vallet e tyre u mirëpritën si në Shoqëri e gjithashtu edhe në publik e veçmas në festivale. Ato valle luhen edhe sot nga gjenerata e re e Shoqërisë. Përshëndetje të veçantë edhe për koreografin Deli Metaliaj dhe për kompozitorin Skënder Doshlani.

Nejazi Dernjani, profesor i muzikës, shkruan:

Artistin, valltarin, koreografin, krijuesin Deli Metaliaj që Hanit të Elezit i dhuroi kryeveprat e koreografisë shqiptare, tablot koreografike; Qëndresë dardane, Lirinë s`ta fal kush, Djemtë dhe çikat

e Sharrit, Shamia e kuqe na bashkoi, Vallja e fëmijëve e bëri që Shoqëria ,,Sharri'' t`i kaloj suazat e amatorizmit dhe ngritjen artistike interpretuese.

Nexhmedin Shkreta, valltar i spikatur i kësaj Shoqërie, shkruan:

I nderuar dhe shumë i respektuar Deli Metaliaj, dua t`ju falënderoj për punën tënde të palodhshme që bëtë për SHKA,,Sharri". Ju ishit koreografi i parë që na mësove hapat e parë të valleve koreografike të cilat shumë breza pas nesh do t`i prezantojnë nëpër festivale. Unë si valltar i kësaj Shoqërie ndihem krenar për një afërsi të madhe që kisha me ju. Fal vlerave tua, në shumë festivale arritëm të marrim çmime të para, andaj ju jemi mirënjohës gjithmonë.

Ajshe Bajrami nga Vitia dhe SHKA„Sharri'' gjatë incizimit në Radiotelevizionin maqedonas, programi në gjuhën shqipe

Valle koreografike origjinale:
Gjatë vitit 2005-2006, SHKA,, Sharri ‘’ realizoi këto valle koreografike:

- Tablo koreografike ,, Qëndresë dardane”
- Valle koreografike: Lulëkuqet e Kosovës
- Duet koreografik: Shamia e kuqe na bashkoi
- Tablo koreografike: Lirinë s`na e fal kush

Gjatë vitit 2008, SHKA ,,Sharri” me donacion të komunës, realizoi edhe këto valle koreografike:

- Valle koreografike: Djemtë dhe çikat e Sharrit
- Valle koreografike e vajzave; Çikat e Sharrit
- Valle koreografike të fëmijëve

Të gjitha këto tablo e valle janë me libret dhe koreografi të Deli Metaliajt dhe kompozitorit Skënder Doshlanit.

Këngët origjinale:
Gjatë viteve 2005-2009, SHKA,,Sharri” realizoi këto këngë origjinale:

- Këngë për dëshmorin Gafurr Loku
- Këngë për dëshmorët Xhemsedin Suma e Nuri Bushin
- Këngë për dëshmorin Veli Ballazhi
- Këngë për dëshmorin Imri Curri
- N` kullë t` Shabanit
- Këngë për dëshmorin Ali Beqa

Të gjitha këngët janë realizuara me tekst të Shaban Çupit, kompozitor Skënder Doshlani, ndërsa i kanë kënduar: Nesim Curri, Nejazi Dernjani e Shefket Beqa. Vlenë të theksohet se melodinë e këngës për dëshmorin Ali Beqa e realizoi Alban Laçi, instrumentalist i Shoqërisë.

Nesim Curri, gjithashtu njëri nga veteranët e SHKA„Sharri'', gjatë interpretimit të këngës për dëshmorin Gafurr Loku në nëntorin e vitit 2005, para qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit

Nuredin Çupi, ekzekutim me gajde, 2005

Alban Laçi, kujton

Në Shoqërinë Kulturore Artistike „ Sharri" jam anëtarësuar në vitin 20001 dhe prej atëherë kam qenë anëtar aktiv pranë kësaj Shoqërie. Aktiviteti im në këtë Shoqëri ka qenë i instrumentalistit në çifteli si dhe në instrumente të tjera muzikore, por kam qenë edhe solist. Në kuadër të grupit të instrumentalistëve folklorik, isha udhëheqës i këtij grupi dhe kam marrë pjesë në shumë koncerte e festivale. Nga viti 2005, 2006, 2007, 2008, 2009 në ekzekutim të valleve koreografike, të cilat zgjatnin deri në 8 minuta, kemi ekzekutuar drejtpërdrejtë dhe grupi i folklorit në përbërje të Alban Laçit, Nuredin Çupit, Nejazi Dernjanit, Burhan Bushit, Bashkim Bushit e Ilir Krasniqit, ishim të suksesshëm dhe grup homogjen dhe të përgatitur profesionalisht. Kjo cilësi është vërejtur si para artdashësve e gjithashtu edhe para jurive të festivaleve ku edhe kemi marrë çmime, thotë Alban Laçi.

Festivali i Vlorës dhe ai i Sarandës

Ndër Festivalet që s`mund të harrohen lehtë nga anëtarët e SHKA„Sharri" është edhe ai i Vlorës dhe Sarandës dhe nga të dy Festivalet, SHKA„ Sharri" kishte ftesë zyrtare.

Nga ftesa për pjesëmarrjen e kësaj Shoqërie në Festivalin e Vlorës të vitit 2005, ndër të tjerat thuhet se ,, Kemi kënaqësinë t`ju ftojmë në Festivalin e Përvitshëm të Polifonisë i cili mbahet më 14, 15 e 16 shtator 2005. Shpenzimet e fjetjes dhe ushqimit do të përballohen nga ana jonë, ndërsa udhëtimi nga ana e juve. Në ftesën zyrtare nga ana e organizatorit kërkohej që, kostumet të jenë tradicionale nga treva juaj, si dhe duhet të përgatiteni për tri koncerte, njëri deri në 15 minuta dhe dy të tjerët nga 30 minuta, të cilët edhe janë realizuar, kujton Nuredin Çupi.

Ndërsa Festivali i Sarandës, i cili u mbajt në shtatorin e vitit 2007, jo vetëm që kjo Shoqëri mori çmime nga juria, por anëtarët e kësaj Shoqërie kishin rastin edhe të vizitojnë pjesën jugore të Shqipërisë, duke ruajtur kujtime të bukura edhe sot.

Në Arkivin e Shoqërisë gjetëm të shkruar edhe pjesëmarrësit që morën pjesë në Festivalin e Këngëve dhe Valleve Çame, në Sarandë i cili u mbajt me 1 e 2 shtator 2007 dhe po e botojmë në tërësi, sepse na i bën të ditur edhe anëtarët që vepruan në këtë Shoqëri:

Nejazi Dernjani, Nuredin Çupi, Alban Laçi, Bashkim Bushi, Burhan Bushi, Shefket Beqa, Ilir Krasniqi, Ajshe Bajrami, Xhevahir Dernjani, Nexhat Thaçi, Avni Thaçi, Enver Thaçi, Agim Dernjani, Jaser Daci, Kushtrim Ballazhi, Gëzim Kalisi, Omer Ballazhi. Iliriana Daci, Arta Axhami, Mersie Thaçi, Xhemile Krasniqi, Arlinda Bakiu, Sahide Bushi, Fjolla Berisha, Afërdita Meliqi, Rinesa Dernjani, Visare Çupi, Abedin Curri dhe Albana Curri.

Anëtarë të tjerë që ishin aktiv në Shoqëri, por që nuk morën pjesë për shkaqe objektive në këtë Festival, ishin edhe:

Venore Vila, Mexhide Brava, Xhejlane Bela, Shyrete Livoreka, Avni Bushi, Adil Bushi, Fitore Çupi, Sefedin Thaçi, Amra Isufi,

Resmije Ballazhi, Sevime Bushi, Adem Brava, Havushe Loku, Hyrije Reçi, Osman Loku, Fuad Curri, Herolinda Ballazhi, Mahmudie Luta, Valdete Brava, Haxhere Brava, Hiremte Brava, Haki Curri, Zylkani Suma, Qëndresa Dernjani, Fatlume Dernjani, Valdete Shkreta, Zejnije Kuka, Egzona Brava, Egzona Daci, Rejhane Ballazhi, Adelina Shyti, Mevlude Shyti, Safije Luri, Ajsere Daci, Adelina Rexhallari, Suad Curri, Erkan Bela, Naim Bajramaliu, Isuf Shyti, Blerina Vila, Valdete Vila, Fjolla Berisha, Mevlude Kalisi, etj. Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe SHKA„Sharri'' kishte rreth 80 anëtarë.

Se Shoqëria Kulturore Artistike„ Sharri" ishte e mirëpritur në Festivalin e Sarandës, sjellim edhe shkrimin nga gazeta Shekulli, pjesë të cilit i shkoqisim si më poshtë:

„ ... Dhe kulmi arrin me daljen në skenë të grupit të ardhur nga Kosova, Shoqëria Artistike „ Sharri" nga Hani i Elezit. Daullet paralajmërojnë një „ shok". Tre tablo përcillen në mesazhin artistik të këtij ansambli: Qëndresa e popullsisë kosovare ndaj gjenocidit serb, terror i ngjashëm me atë që ka përjetuar popullsia çame në mesin e viteve të 40-ta; rritjen e parakohshme të të rinjve për tu „ burrëruar'' e për të hyrë në radhët e luftëtarëve të lirisë dhe simbolika e tre pishtarëve të nisur prej Kosove, kaluar në Shqipëri, përfunduar në Çamëri, simbolikë që siç u vlerësua edhe nga të pranishmit, është flaka e ndezur dhe mbajtur gjallë me zjarrin e shpirtrave shqiptarë për t`i parë viset shqiptare të lira dhe që do të komunikojnë pa pengesa mes tyre. Ishte ky grup që juria, me të drejtë e vlerësoi me çmimin e parë. SHKA „SHARRI" , Hani i Elezit, ka për udhëheqës artistik Nejazi Dernjanin, kompozitor Skënder Doshlanin dhe koreograf Deli Metaliaj...."[37]

[37] Burimi: Shekulli.com.al

Vallja koreografike,, Lirinë s`ta falë kush" u mirëprit në këtë festival, pasi që kjo valle jo vetëm që reflektonte dëbimin e popullatës së Kosovës nga pushtuesi serb në vitin 1999, por kishte domethënie krejtësisht të ngjashme me dëbimin e shqiptarëve nga Çamëria nga pushtuesi grek, andaj jo vetëm që u mirëprit nga publiku i Sarandës, por edhe juria ia dha çmimin e merituara. Ndaj këtij suksesi, kam gëzim të dyfishtë, pasi që isha edhe donatori i plotë i kësaj valleje, kujton Nuredin Çupi.

Në Arkivin e Shoqërisë gjetëm edhe një shkrim në të cilin pasqyrohen pjesëmarrësit e Shoqërisë në Festivalin ,,Sofra Dardane" në Bajram Curr.

Në grupin e valltareve bënin pjesë:

Iliriana Daci, Xhemile Krasniqi, Arta Axhami, Arlinda Bakiu, Blerina Vila, Mersije Thaçi, Ilirida Rexhallari, Adelina Rexhallari.

Në grupin e valltarëve:

Enver Thaçi. Avni Thaçi, Nexhat Thaçi, Agim Dernjani, Jaser Daci, Kushtrim Ballazhi, Erkan Bela, Gëzim Kalisi, Abedin Curri.

Orkestrina:

Nejazi Dernjani, Nuredin Çupi, Alban Laçi, Bashkim Bushi, Burhan Bushi, Shefket Beça, Ilir Krasniqi.

Këngëtarët:

Ajshe Bajrami, Liridona Bajrami, Albana Curri, Rinesa Dernjani, Visare Çupi, Venore Vila.

Vlen të theksohet se krahas këtij numri jo të vogël të anëtarëve të cilët gjatë viteve parakaluan në SHKA,,Sharri'' e të cilët kush më shumë e kush më pak dhanë kontributin e tij në jetën kulturore, kjo Shoqëri për një kohë, sidomos në vitin 2005, ka bashkëpunuar edhe me solistë, valltarë e instrumentalist nga Kaçaniku si: Zejadin Raka, Shqipe Krivanjeva, Kosovare Hashani, Fatbardha Hashani, Mihane Dullovi, Blerina Dullovi, Ganimete Hasaj,

Vjollca Zeneli, Burbuqe Shehu, Kerim Palloshi, Ramiz Hashani, Malsore Guri, Shkodran Raka (i ndjerë) një pjesë nga të cilët kanë marrë pjesë edhe në festivalin e Vlorës në vitin 2005 dhe në atë të Tropojës.

Krahas këtyre bashkëpunimeve, Shoqëria ,,Sharri" ka bashkë-punuar edhe me këngëtaren Ajshe Bajrami nga Vitia e cila disa herë ka marrë pjesë në programet e Shoqërisë dhe është mirëpritur nga publiku.

Libreti koreografik

Libreti i koreografisë ,, Lirinë s`ta fal askush" e ideuar nga koreografi Deli Metaliaj, nga qyteti i Bajram Currit, Tropojë, ndërsa e realizuar nga SHKA ,,SHARRI", në vitin 2006, valle e cila u mirëprit dhe u vlerësua lartë nga juritë profesionale, kudo që u paraqit kjo Shoqëri artistike

Përmbajtja:

Ky libret trajton një temë patriotike të mbarë popullit shqiptar e në veçanti popullit të Kosovës, që në çdo kohë me Dardanët, diti të bëj rezistencë armiqve shekullor deri në luftën e fundit të vitit 1998-1999.

Pra, zhvillimi ynë kombëtar është përcjellë me ngjarje të vogla e të mëdha gjatë shekujve. Ka këtu edhe humbje edhe ngadhënjime të shkaktuara nga faktori i brendshëm dhe ai i jashtëm që determinuan rrugës së rezistencës, të luftës, sakrificës dhe mbijetesës deri më sot.

Kjo e kaluar flet me gjuhën e ndjekjeve, burgosjeve, torturave, djegieve, gjyqeve , likuidimeve dhe të etnocidit, por njëkohësisht flet edhe për krenarinë e sakrificën duke e poetizuar vizionin për ardhmërinë. Këtë e kishte vërejtur edhe Edith Durham kur thoshte: ,, Sigurisht se asnjë racë nuk ka luftuar më shumë për lirinë në të gjitha epokat se ajo shqiptare".

Lufta e Kosovës, është luftë e gjatë kundër pushtuesve të njëpasnjëshëm. Nëpërmjet këtij libreti, del në pah edhe forca e femrës shqiptare, qëndresa e saj, rezistenca e saj në shekuj e cila krah për krah me burrin diti të luftoj, të punoj e derisa për atdheun e vet, dha edhe jetën.

Zëri i Nënlokës simbolizon zërin e Shqipërisë, pra nënës Shqipëri, që thërret bijtë e bijat e saja për t`u bashkuar e luftuar njëherë e mirë armikun shekullor dhe çlirimin trojeve etnike shqiptare.

Nëpërmjet këtij krijimi koreografik, në formën e thjeshtë a-b-a do të realizojmë këtë tablo koreografike.

Episodi i parë:

Ritmi 2/4, çdo lodër hyn njëherësh për të imituar një karavan njerëzish që largohen nga trualli i tyre për në një vend tjetër.

Në skenë hyjnë të gjithë valltarët, dikush zbathur, dikush grisur rrobash, me trasta në shpinë e me fëmijë për gryk.

Muzika 2/4, prekëse e shumë domethënëse, djalë e vajzë me leksikun kërcyes shprehin largimin e popullit të Kosovës nga trojet e tyre, ku serbi nuk ka farë mëshire për ata; i vret, i masakron, i përdhunon.

Këtu mbaron pjesa e parë e valles me gjithsejtë 16 tetëshe ose 64 masa, muzikë 2/4, ku mendimi muzikor duhet të përputhet mirë me mendimin koreografik ku intonohen njëra me tjetrën dhe del në pah më së miri pjesa e parë koreografike.

Episodi i dytë:

Dëgjohen tingujt e një lahute ku së bashku me tingujt e saj, dëgjohet edhe zëri i një femre. Kjo femër simbolizon Nënloken e cila duke thirrur del në skenë me një zë të fortë e kumbonjës : ,,O njerëz ejani, ku jeni, nga po shkoni, toka është e jona. Qytetet , fshatrat dhe bjeshkët të tonat janë”

Menjëherë karavani ndalon, menjëherë e rrethojnë Nënloken dhe besatohen me të se truallin dhe atdheun e tyre kurrë nuk e lënë, fëmijët ulen në prehrin e Nënlokes dhe trimat rrethojnë fëmijët duke u betuar.

Këtu mbaron Episodi i dytë, muzika 2/4 prekëse me gjithsejtë 18 tetëshe ose 72 masa muzikore. Pas kësaj dëgjohen breshëri armësh, që imiton lodra, pra 2 tetëshe ose 8 masa.

Episodi i tretë:

Episodi i tretë fillon me një këngë korale ku nëpërmjet vargjeve të këngës del në pah imazhi i qëndresës dhe i rezistencës të popullit të Kosovës që diti t`i bëj ballë dhe t`i rezistoj armikut serb.

Këtu, me 16 tetëshe ose 64 masa muzikore, mbaron pjesa e tretë e valles. Vallja vjen sa më e fortë, shpërthyese e dinamike dhe të gjithë sikur këndojnë, dalin nga skena me lirinë e fituar.

Xhemile Krasniqi dhe grupi gjatë interpretimit të valles koreografike ,, Lirinë s`ta fal kush” në vitin 2007

SHKA,,Sharri” gjatë një koncerti në Shkup

Një fotografi e vitit 2005 e Shoqërisë Kulturore Artistike ,,Sharri’’ me koreografin Deli Metaliaj. Kujtim i bukur nga bashkëpunimi, angazhimi dhe dëshira për suksese të reja artistike.

Shefket Beça, anëtar i SHKA,,Sharri'' nga viti 2001. Ndryshe njihet si bilbili i Shoqërisë i cili me zërin e tij të ëmbël shpejt përfitonte publikun. Shefket Beça me këngët e tij të preferuara për UÇK-në, për dëshmorin Tahir Sinanin, Zhuj Selmanin, Moj Shipni mos thuaj mbarova, dëshmorin Ali Beçën si dhe këngë të tjera nga repertori i tij, ishin dhe mbetën një vlerë artistike.

Shefket Beça, pranë Shoqërisë ka kënduar edhe vet edhe në duet si me Nuredin Çupin, Ajshe Bajramin, Nejazi Dernjani, Nesim Currin dhe grupin. Krahas kësaj bënte pjesë edhe në orkestrinën e grupit folklorik. Nëpër festivale është shpërblyer disa herë. Gjatë luftës, Shefket Beça ishte i burgosur politik dhe ka qenë bashkëvuajtës me autorin e kësaj monografie në burgun e Nishit. Kur ofrohej ndonjë mundësi e vogël në rrethanat e burgut, ia thoshte këngës bashkë me rapsodët Enver Dugolli nga Drenasi e Naim Lushin nga Peja.

Shefket Beça edhe sot është aktiv në Shoqërinë Kulturore Artistike ,,Sharri" dhe këngët e tij mirëpriten nga publiku.

Padyshim se meritor për sukseset e SHKA„Sharri'' nga periudha 2005-2009 është edhe Grupi folklorik i kësaj Shoqërie, në përbërje të: Alban Laçit, Nuredin Çupit, Nejazi Dernjanit, Shefket Beça, Bashkim Bushit, Burhan Bushi, Adem Brava e Ilir Krasniqi, të cilët gjithnjë ishin në nivelin e detyrës, madje edhe me ekzekutimin e valleve koreografike 8 minutëshe. Në aspektin profesional, ishte një orkestrinë shumë e përgatitur e folklorit tonë popullor. Ekipi i këtij grupi do të mbahen mend gjatë si një vlerë artistike në komunën e Hanit të Elezit.

Grupi i të rinjve i SHKA,, Sharri" në shënimin e datave memoriale të komunës së Hanit të Elezit

SHKA,,Sharri" nëpër festival të ndryshme , arriti të korrë një varg rezultatesh ku edhe mori çmime, Mirënjohje e Diploma të cilat i shpalosim si më poshtë:

- Mirënjohje nga kryetari i komunës së Hanit të Elezit Mallzum Qajani më 11.6.2006 për afirmimin e trevës dhe kultivimin e vlerave kulturore
- Në vitin 2006 në Gjonaj të Hasit, Plaketa e festivalit
- Në Dej të Rahovecit dhe në Klinë, vendi i parë si shoqëri
- Në,, Anadrinia jehon-2007", Diplomë për duet më të mirë Shefket Beça e Nuredin Çupi
- Festivali Folklorik „ I këndojmë lirisë" në Klinë në vitin 2007, për SHKA SHARRI për vallen më të mirë ndanë Mirënjohje
- „ Anadrinia jehon – 2007, Mirënjohje për SHKA,, Sharri"
- Festivali Folklorik „ I këndojmë lirisë" ndanë Mirënjohje për „Sharrin'' më 8 qershor 2007
- Mirënjohje merr „Sharri'' edhe nga Këshilli Vendor i fshatit Sllupçan, më 2 maj 2007
- Me këngën për Zhujë Selmanin dueti Shefket Beqa-Nejazi Dernjani marrin vendin e parë në Prizren
- Çmimin e parë SHKA „Sharri" e merr edhe në „ Sofra Dardane 2007" dhe çmimi jepet nga Unioni Artistik Shqiptar me president Azgan Haklajn
- Çmimi i parë jepet e dhe në Sarandë në gushtin e vitit 2007 ku SHKA „Sharri" mori pjesë në Festivalin e Parë të Këngëve dhe Valleve për Çamërinë. Çmimi jepet nga Drejtori i Përgjithshëm Artistik i Festivalit, Minella Kureta
- Ansambli i këngëve dhe valleve „ Kemajl Azizi" në Viti, ndanë Mirënjohje për SHKA „ SHARRI" më 5.6.2008
- Unioni Artistik i Kombit Shqiptar: Mirënjohje për pjesëmarrje në festivalin e 11 „ Sofra Dardane 2013"

Enver Thaçi njëri nga valltarët e dalluar të Shoqërisë

Përfundoi festivali „Sofra Dardane" në Bajram Curr të Shqipërisë

SHKA „SHARRI" NGA HANI I ELEZIT MORI VENDIN E PARË NË VALLEN INSTRUMENTALE

Shoqëria Kulturore Artistike „Sharri" nga Hani i Elezit,pas ftesës që mori nga organizatori i festivalit „Sofra Dardane" nga qyteti i Bajram Currit, në mënyrë të organizuar udhëtoi për në Shqipëri,ku pos pjesëtarëve të SHKA „Sharri" ishin edhe deputeti Berat Luzha si dhe Drejtori i DKRS, Ibush Vishi.

Në qytetin e Bajram Currit,mirëseardhje u uroi koreografi Deli Metaliaj me stafin e organizimit të festivalit „Sofra Dardane 2005" si dhe këngatari Arif Dushaj i cili pos mikëpritjes falënderoi edhe për pritjen kaçanikase në festivalin „Kaçaniku 2005" mbajtur kohë më parë.

Sistemimi i antarëve të shoqërisë u bë në hotelin tanimë i privatizuar „Turizmi" ku pos SHKA „Sharri" ishin edhe shoqëritë e tjera,ndërsa në festivalin „Sofra Dardane" merrnin pjesë edhe Ansamble nga Gjirokastra,Deçani,Mitrovica,Fieri,Shkupi,Tirana,e tj.

SHKA „Sharri" nga Hani i Elezit u paraqit ditën e dytë të festivalit,pikërisht me 16 qershor,në ambient të hapur, në prani të shumë spektatorëve dhe pas kësaj shoqërie u paraqitën edhe Ansambli nga Kraba i Tiranës,Bilbilat e Kolonjës nga Gjirokastra,Myzeqeja e Fierit dhe Ansambli Popullor nga Mitrovica dhe në fund të këtij festivali nga juria profesionale për SHKA „Sharri" të Hanit të Elezit u nda vendi i parë në vallen instrumentale,krahas Deçanit i cili mori vendin e

Pamje nga programi i shfaqur nga SHKA "SHARRI" - Hani i Elezit

SHKA "Sharri", shoqëria më e mirë

RAHAVEC, 19 MAJ - SHKA "Sharri" nga Hani i Elezit u shpall shoqëria më e mirë në festivalin tradicional "Anadrinia jehon", që u mbajt në Rahavec. Vendi i dytë i takoi SHKA "Gurra" nga Gjilani dhe i treti SHKA "Minatori" nga Kishnica. Solistja më e mirë në valle, këtë vit u shpall, Gjenete Aliu, (SHKA "Opoja" - Sharr), kurse rapsodët më të mirë ata të SHKA "Salih dhe Feriz Krasniqi" nga Malisheva. Të shpërblyerit të tjerë: SHKA "Zëri i Kosovës" nga Fushë-Kosova - orkestra më e mirë, SHKA "Gurra" nga Gjilani - vallja më e mirë dhe SHKA "Jehona e Dukagjinit" nga Klina - dueti më i mirë. Valltarja Bubë Mici, nga Tropoja, u nderua me çmimin e karrierës.

B.Sokoli

SHKA "Sharri" rrëmben çmimin "Mujë Krasniqi"

KLINË, 9 QERSHOR - SHKA "Sharri" nga Hani Elezit ka rrëmbye çmimin "Mujë Krasniqi", në festivalin folklorik "I këndojmë lirisë", q u mbajt me 6, 7 dhe 8 qershor në Klinë, për nder të ditëlindjes s komandantit të UÇK-së, Mujë Krasniqi - Kapuçi. Për tri net ra radhë, shoqëri, grupe dhe folkloristë të shumtë nga të gjitha vise shqiptare, kanë shpalosur aspekte të folklorit, të cilat, me gjithë motin e lig, janë përcjellë nga një numër i madh i qytetarëve. Çmimi i dytë në këtë festival i takoi SHKA "Drenica" nga Skenderaj, ndërs çmimi i tretë SHKA "Dita" nga Shtimja. Fituesit e çmimeve të tjer të festivalit: Grupi më i kompletuar, "Valët e Liqenit" nga Ladorisht e Strugës, veterani i festivalit, Gjergj Kola, teksti me i mirë, Emi Raci, veshja më autentike "Zëri Shalës" nga Mitrovica dhe instru mentisti me i mirë, Kadri Abazi. Çmimin e publikut në edicionin sivjetmë të këtij festivali e fitoi ansambli "Shqiponja" nga Tirana.

Agron Gash

Çmimet e Festivalit

Juria në përbërje nga dr. Zymer Neziri, kryetar i jurisë (punonjës shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës), Rami Ymeri, kompozitor, Deli Metalia (nga Tropoja, koreograf), Minire Fetahu (redaktore e muzikës në RTK) dhe Prend Buzhala, publicist e krijues letrar, ndau këto çmime: 1. Vallja më e mirë - "Lirinë nuk na e fal askush" SHKA "Sharri" - Hani i Elezit, 2. Instrumentisti/ja më e mirë - Sylë Malaj, 3. Çmimi i Publikut-Sinan Gashi e Shkelzen Morina, 4. Veshja më Autentike-Shka nga Ulqini, 5. Teksti më I mire- SHKA "Muje Krasniqi" Çabiq, 6. Veterani i Festivalit- Zija Aliu- SHKA "Kemajl Azizi"- Viti, 7. Grupi më i kompletuar - SHKA "Ulpiana" - Lipjan, Çmimin: 1. Vendi i Tretë - "Zëri i Shalës" - Mitrovicë, 2. Vendi i Dytë - SHKA " Shote Galica " - Orenas, 3. Çmimin "Mujë Krasniqi" - Rrëshen - Mirditë.

"Anadrinia jehon 2008"

Lahuta e festivalit në duar të SHKA "Sharri" nga Hani i Elezit

RAHAVEC,14 MAJ - Pas prezantimit Çmimin "Veshja më e mirë" e fito

Ishin të shumta mirënjohjet dhe çmimet që mori SHKA,,Sharri" nëpër festivale

Kronika gazetareske për SHKA„SHARRI" shkruara nga Shaban Çupi

Më 12 maj 2006, në festivalin,, Hasi këndon 2006 '' në Gjonaj të Prizrenit, SHKA,,Sharri'' korri edhe një suksese të madh. Në një konkurencë mjaftë të fuqishme, nga juria profesionale e festivalit për vallen më të bukur duet ,,Shamia e kuqe na bashkoi'' kjo shoqëri mori çmimin ,,Pllaketa e Festivalit''
SHKA,,Sharri'' krahas koncerteve shumë të suksesshme në Han të Elezit, Shkup e Tetovë, me 6 maj të këtij viti dha një koncert shumë të mirëpritur edhe në qytetin e Bajram Currit të Shqipërisë.

SHKA,, Sharri" s`mund të quhet më Shoqëri amatore
Shoqëria Kulturore Artistike ,,Sharri'' nga Hani i Elezit është themeluar në vitin 1974. Në dekadat që kaluan, kjo shoqëri kishte ngritjet dhe rëniet e saj, varësisht edhe nga situata politike që zhvillohej në Kosovë. Fillimisht kjo Shoqëri ka vepruar në kuadër të kombinatit ,,Sharri'', i cili edhe e financonte, por kohërat që rrodhën, aktiviteti kulturor mbeti në duar të artdashësve vullnetar, ashtu siç është edhe sot.
Kryetari i saj, Mehmet Ballazhi, thotë se SHKA,,Sharri'' është një shoqëri e cila aktualisht ka rreth 50 anëtar dhe me ndihmën e koreografit nga Shqipëria Delia Metaliaj si dhe kompozitorit Skënder Doshlani, ka arritur të ngritet artistikisht dhe të krahasohet me shoqëritë e qyteteve më të mëdhaja të Kosovës. Ne, vazhdon z.Ballazhi, kemi dhënë disa koncerte si në Kosovë, Shkup e Tetovë, por koncerti që u dha në Bajram Curr të Tropojës, shënon edhe një ngritje të re organizative dhe cilësore. Krahas kësaj, SHKA,,Sharri'' këtyre ditëve mori pjesë edhe në dy festivale të rëndësishme: në atë të Rahovecit dhe të Hasit të Gjonajve, ku u shpërblyem me ,,Pllaketën e festivalit'' ndërsa koreografi Deli Metaliaj rreth aktivitetit në këtë shoqëri thotë se lidhjet me ,,Sharrin'' e Hanit të Elezit kanë filluar që nga festivali i vjetëm i

Kaçanikut dhe brenda kësaj periudha një vjeçare që kam qenë në kontakt me këtë shoqëri, shpreh mendimet e mia se pjesëtarët e ,,Sharrit'' janë të disiplinuar, kanë një udhëheqje që kërkon punë dhe krahas sukseseve që kanë arritur deri më tani, ata do të arrijnë edhe suksese të tjera. Çmimet që kjo shoqëri mori në Rahovec dhe në Gjonaj të Hasit, këtyre ditëve janë dëshmi se Sharri nuk është më shoqëri amatore, por për çdo ditë e më shumë profesionale.

Edhe një sukses i madh i SHKA,,Sharri''
SHKA,,Sharri'' nga Hani i Elezit ka rrëmbyer çmimin ,,Mujë Krasniqi'',në festivalin folklorik ,,I këndojmë lirisë'' që u mbajt me 6,7dhe 8 qershor në Klinë, për nder të ditëlindjes së komandantit të UÇK-së, Mujë Krasniqi-Kapuçi, shkruan për Kohën Ditore gazetari Agron Gashi, duke vazhduar se për tri net me radhë, shoqëri, grupe dhe folkloristë të shumtë nga të gjitha viset shqiptare, kanë shpalosur aspekte të folklorit, të cilat, me gjithë motin e ligë , janë përcjellë nga një numër i madh i qytetarëve. Çmimi i dytë në këtë festival i takoi SHKA,,Drenica'' nga Skenderaj, ndërsa çmimi i tretë SHKA,,Drita'' nga Shtimja.
Mehmet Ballazhi, kryetar i shoqërisë, tha se kjo është një e arritur e madhe e anëtarëve të shoqërisë sonë dhe në këtë festival ishte një konkurrencë e madhe prej 40 shoqërive, andaj ky çmim neve na motivon edhe më shumë për suksese të reja duke shtuar se nga ky festival SHKA,,SHARRI'' është klasifikuar edhe në festivalin e Prizrenit ku gjithashtu presim se do të kthehemi me ndonjë çmim të festivalit.
Shaban Çupi, 9 qershor 2006

Kronikë nga dorëshkrimi:

Është hera e parë që udhëtoj për në Tropojë e cila në rend të parë më kujton rapsoden, tani të ndjerë, Fatime Sokoli. Ajo, me këngët e bukura të vitit 1981, të cilat i dëgjonim fshehurazi ,,dridhte'' Kosovën. Krahas kësaj, s`kam si të mos jem i gëzuar që vizitoj Valbonën, emrin e së cilës shumë vajza e mbajnë me krenari në Kosovë. Në këtë kronikë udhëtimi, s`kam si të mos shkruaj për Grykën e Dragobisë, për Shpellën e saj, aty ku ra Bajram Curri dhe këngën e cila u ngrit nga populli:

Bajram Curri i ri
Lufton për liri...
Bajram Curri plak
Mjekrra i kullon gjak...

Rrugës për Tropojë, s`kam si të mos kujtoj këngëtarin Gzim Nika, si dhe këngët dhe vallet e Tropojës epike të cilat shfaqeshin dekadave më parë në Festivalin e Gjirokastrës, e që valët e Televizionit Shqiptar si për inat të jugosllavëve, na pranveronin shpirtin tonë, programe të cilat i përcjellim fshehurazi, falë disa antenave që atë botë i quanim pesëshe.

,, Sofra dardane'' është mikëpritsja e qindra artistëve anë e kënd atdheut dhe afër ,,sofrës'' është statuja e Bajram Currit, emrin e të cilit e ka marrë edhe vet qyteti. Pranë ,, sofrës'' parakalojnë Shoqëri e Ansamble nga më të ndryshme. Secila shfaqë në mënyrën e vet trashëgiminë tonë kulturore të ruajtur brez pas brezi. Një shfaqje të tillë e bën edhe Shoqëria ,, Sharri'' nga Hani i Elezit dhe ndahemi të kënaqur me prezantimin e saj para publikut.

Meqë Bujani nuk është larg nga qyteti i Bajram Currit, vizituam edhe shtëpinë ku u mbajt Konferenca e Bujanit më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944, vendimet e së cilës sollën vullnetin popullor: Kosova duhet të bashkohet me Shqipërinë!

Krahas kësaj, një vizitë kureshtare bëmë edhe në një kullë të këtij fshati, ku i zoti i kullës na priti me një bujari të rrallë, përkundër varfërisë që e përshkonte këtë fshat. Nuk lamë pa e vizituar as kullën e Mic Sokolit, njëri nga komandantët e shquar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Shaban Çupi, qershor 2007

Abedin Curri dhe grupi, para publikut të komunës së Hanit të Elezit në vitin 2008

Veteranët e SHKA „Sharri" para publikut të Hanit të Elezit

Është kënaqësi kur veteranët e këngës, të cilët hapat e parë i bënë në këtë qytezë të vogël, por me zemër të madhe, herë pas here i kthen publikut të vendlindjes. E tillë është edhe Lumturie Axhami e cila nuk e harron vendlindjen e saj. Ajo nuk harron as atmosferën e cila krijohej në sallën e vogël të kinemasë , siç i thoshim atëherë dhe brohoritjet e artdashësve Lume, Lume..., edhe një, edhe një. Ende i kemi të freskëta veshjen e saj të bukur dhe këngët: Kam qëndisur një shami, Kur e përcolla Ylberin, Ibe Palikuqin, etj, këngë të cilat këndoheshin para 30 viteve. Ajo, pas migrimit në Maqedoni, aktivitetin e saj e ka vazhduar në shoqëritë kulturore artistike të Shkupit. Ka realizuar shumë këngë në radiotelevizione dhe studio të ndryshme. Lumturie Axhami, ndryshe njihet si kanarina e Shoqërisë dhe aktivitetin e saj e vazhdon edhe sot në Kërçovën e bukur.

Veteranë të tillë, që kohë pas kohe i kthehen publikut me zërin e tyre të bukur, janë edhe Shengyle Berisha, Shaban Rogaqi e Ekrem Rogaqi. Këngët e tyre të bukura dhe të vlerësuara lartë nga juria e Festivaleve, s`ka si mos t`na kujtohen edhe sot. Kudo që shkuan dhe kudo që u shfaqën para publikut,atëherë dhe sot, afirmuan këngën burimore shqipe dhe njëkohësisht trevën e Hanit të Elezit. Ata, atëbotë, nuk dinin çka ishte CD-ja. Ata shfaqeshin natyrshëm, të drejtpërdrejtë dhe këngët e tyre ishin larg shundit e deformimeve të tjera muzikore.

Shaban Rogaqi e Ekrem Rogaqi, me këngët e tyre rapsodike janë aktiv edhe sot, ndërsa Shengyle Berisha, vlerat burimore të këngës shqipe i shfaq edhe para mërgimtarëve në Norvegji, ku aktualisht jeton.

Avni Bushi gjatë një koncerti të Shoqërisë, gjithnjë i mirëpritur me këngët e tij për dëshmorët e Hanit të Elezit. Ai thot se, çdo herë kam marr pjesë në aktivitete që janë organizuar për datat me rëndësi kombëtare. Kam realizuar disa këngë për dëshmorët e Komunës së Hanit të Elezit, si: këngën për Gafurr e Driton Loku, Marsi sjell pranverën, këngën për dëshmorin Ilaz Thaçi, Elham Curri, Ali Beça, Një betim e bëjnë luftëtarët, etj, këngë të cilat janë prezantuar në datat më të rëndësishme të komunës së Hanit të Elezit.

Vëllezërit Brava (Ekremi, Xhaviti e Xhemili) me këngët e tyre rapsodike gjatë një programi para qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit

Rapsodët dhe njëkohësisht veteranët e Shoqërisë, Shaban e Ekrem Rogaqi gjatë një manifestimi, çdo herë të mirëpritur nga qytetarët e komunës së Hanit të Elezit

Riorganizimi, udhëheqja dhe anëtarët aktual të SHKA„Sharri”

Shoqëria Kulturore Artistike,, Sharri", që të hapëroj shtigjeve të reja, kohë pas kohe kishte nevojë për riorganizime. Kur të kihet parasysh se puna dhe veprimtaria pranë Shoqërisë është krejtësisht në baza vullnetare, riorganizimet e tilla disi bëheshin të domosdoshme.

Riorganizimi i fundit në këtë Shoqëri u bë në vitin 2012, konkretisht më 26.3.2012 dhe nga mbledhja e mbajtur me anëtarët e kësaj Shoqërie, rezultoi kjo kryesi e cila është edhe sot:

Muharem Rogaqi, kryetar
Alban Laqi, anëtar
Xhemil Brava, anëtar
Xhevdet Bushi, anëtar
Burhan Bushi, anëtar.

Nga kjo Kryesi u organizua edhe koncerti për Ditën e Çlirimit më 11 qershor 2012, ndërsa në muajin gusht, për nder të Ditës së Dëshmorëve u realizua edhe një koncert për këtë ditë. Një koncert para publikut hanelezas u realizua edhe për Ditën e flamurit, në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, ku krahas Shoqërisë, morën pjesë edhe rapsodët Shaban e Ekrem Rogaqi si dhe Shengyle Berisha, veteranë të kësaj Shoqërie. Koncerte të tilla kjo Shoqëri dha edhe gjatë vitit 2013, qoftë për 17 shkurtin shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës si dhe 26 shkurtin Ditën e krismave çlirimtare në Puset e Nikës. Një aktivitet i tillë u bë edhe për 8 marsin, Ditën ndërkombëtare të gruas. SHKA,,Sharri" po gjatë këtij viti, mori pjesë edhe në festivalin e Klinës ku edhe mori vendin e dytë si dhe në ,,Sofra dardane 2013'' në Tropojë. Me një aktivitet të tillë Shoqëria ,,Sharri" kishte edhe në vitin 2014, duke shënuar datat e rëndësishme të komunës së Hanit të Elezit si 17 shkurti e 26 shkurti dhe në të gjitha rastet kjo Shoqëri është mirëpritur nga

publiku. Krahas këtij aktiviteti, SHKA,,Sharri" ka arritur që publikut të Hanit të Elezit t`i sjellë edhe Shoqëri të tjera artistike si ,, Shqiponjën" nga Kaçaniku, ,,Shqiponjat e Sarajit" nga Shkupi si dhe SHKA,, Drita" e Dërvenit, të cilat para publikut të kësaj komune sollën vlera të trashëgimisë sonë kulturore kombëtare. Mysafirë në koncertet e kësaj Shoqërie ishin edhe Adem Bllaca, Luljeta Idrizi, Kerim Palloshi, Alban Hysa dhe krahas këtyre Shoqërive, në komunën e Hanit të Elezit, për manifestime të ndryshme kanë marrë pjesë edhe artistë nga estrada jonë si: Mahmut Ferati, Labinot Tahiri, Burim Aliu, Afrim Muqiqi, Riva Kajtazi, Violetë Kukaj, Afërdita Demaku dhe Milaim Mezini i cili me këngën e njohur për dëshmorët e komunës së Hanit të Elezit, çdo herë ishte i mirëpritur dhe i duartrokitur nga qytetarët e komunës së Hanit të Elezit. .

SHKA,,Sharri'' në vitin 2014

Instrumentalistët e SHKA,,Sharri" në vitin 2014[38]:

[38] Informatë nga Muharrem Rogaqi e Alban Laçi dhënë autorit më 25.3.2014

Muharrem Rogaqi (klarinet), Alban Laçi (çifteli), Xhemil Brava (çifteli), Burhan Bushi (sharki), Fadil Vila (harmonikë), Sefer Rogaqi (def), Naim Rexha (kitarë), Bashkim Bushi(çifteli).
Alban Laçi është udhëheqës i grupit folklorik.
Këngëtarët:
Shefket Beqa, Avni Bushi, Kadri Rogaqi, Abil Thaçi, Shaban Rogaqi, Ekrem Rogaqi, Xhavit Brava, Fadil Brava, Zulkani Suma, Xhylsime Bushi, Valdete Kalisi, Nurtene Brava, Vildane Brava, Hyrijete Kalisi, Ibadete Kalisi.

Valltarët, udhëheqës Enver Thaçi e Omer Ballazhi
Enver Thaçi, Omer Ballazhi, Burhan Reqi, Bujar Reqi, Besnik Rogaqi, Fatmir Luri, Adil Bushi, Besar Qajani, Fatlum Kalisi, Fabion Brava, Flamur Hasallari, Ebubekër Tuqi, Lavdrim Ballazhi, Florim Daci, Adhurim Bushi, Besir Livoreka, Ramadan Thaçi, Shpëtim Hasallari, Nazmi Huneli, Egzon Kalisi, Kushtrim Loki, si dhe valltaret:
Larglinda Berisha, Arta Berisha, Hikmet Lusnjani, Xhemile Lusnjani, Tafije Berisha, Ibadete Kalisi, Hyrijete Kalisi, Xhemile Kalisi, Shukrie Axhami, Albana Laçi, Merale Brava, Alma Thaçi, Samire Thaçi, Hanife Thaçi, Kushtresa Loku, Shpresa Shyti, Egzona Topojani, Sheqibe Rogaqi, Kujtesa Tuçi, Florentina Livoreka, Emire Kalisi, Shqipe Tuçi, Anisa Livoreka dhe Emine Kalisi.

SHKA,,Sharri" , gjatë një koncerti në vitin 2013

SHKA,,Sharri'' para publikut të Hanit të Elezit, 2014

Kryetarët e SHKA„Sharri”

Natyrisht se kryetarët e Shoqërisë kishin një rol të veçantë dhe një përgjegjësi jo të vogël në zhvillimin e jetës kulturore në trevën e Hanit të Elezit. Ata duhej të mendonin për shumë çka: për mbajtjen e vazhdimësisë së Shoqërisë, shtimin e anëtarëve të rinj, sigurimin e mjeteve materiale, instrumenteve, veshjeve dhe transportin e Shoqërisë. Kryetarët e SHKA,,Sharri” në vazhdimësi janë përballur me kërkesa të tilla, andaj mbeten edhe meritorët e sukseseve të kësaj Shoqërie. Që nga themelimi i Shoqërisë e deri më sot, kryetarët e SHKA,,Sharri” ishin:

1. Nuriman Kuka, dhjetor 1975 - maj1981
2. Adem Shkreta, qershor 1982 - shtator 1984
3. Faruk Daci, tetor 1984 - 1989
4. Rufki Suma (kryetar i SHKA,,Ismail Qemali’’ 1993-1997)

5. Fadil Curri, korrik1999 - maj 2001
6. Rexhep Shkreta, gusht 2001 - qershor 2003
7. Sherif Berisha, korrik 2003 - nëntor 2005
8. Nejazi Dernjani, dhjetor 2005
9. Mehmet Ballazhi, janar 2006 - korrik 2007
10. Nuredin Çupi, shtator 2007 – korrik 2009
11. Muharrem Rogaqi, 2012

Nuriman Kuka

Adem Shkreta

Faruk Daci

Rufki Suma

Fadil Curri

Rexhep Shkreta

Sherif Berisha

Nejazi Dernjani

Mehmet Ballazhi

Nuredin Çupi

Muharrem Rogaqi

Përmbyllje

Është një sfidë jo e vogël t`i rrekesh një pune monografike të një aktiviteti 40 vjeçar, nëpër të cilin kanë kaluar shumë veprimtarë e aq më tepër kur trevës sonë, për shkak të rrethanave që kaloi, nuk kishte arkiv komunal, të cilit do t`i referohej autori i kësaj monografie.

SHKA„Sharri" për katër dekada me radhë, zhvilloi jetën kulturore në trevën tonë, dhe nga gjiri i saj lindën talent të këngëve e valleve popullore të cilët prezantuan vlerat muzikore të kësaj treve në hapësirat tjera shqiptare.

Me aktivitetin dhe rezultatet e saj, kjo Shoqëri na bëri që treva jonë të jetë konkurrente dhe njëkohësisht krijoi lidhje bashkëpunimi me Shoqëritë e tjera artistike.

Nëpër podiumin e kësaj Shoqërie parakaluan shumë anëtarë, por jo të gjithë kishin arritur majat e suksesit dhe kjo është e vetëkuptueshme.

Krahas aktivitetit që kishte nëpër dekada, kjo Shoqëri kishte edhe problemet e saja saqë nganjëherë edhe ndërpritej aktiviteti për një kohë të caktuar për t`u ringjallur përsëri.

Kjo Shoqëri, duke pasur parasysh edhe rrethanat kur veproi, nuk arriti të deponoj shënime kronologjike dhe të vazhdueshme të aktivitetit të saj, gjë që na e vështirësoi zbardhjen e detajeve të aktivitetit.

Ruajtja e fotografive nga anëtarët e Shoqërisë, për ne ishte arkivi domethënës dhe atë e shfrytëzuam për aq sa kishim mundësinë dhe kemi kënaqësinë që po ua ofrojmë gjeneratave të reja artdashëse.

Nëpër faqet e kësaj monografie, në mënyrë kronologjike dhe të ndara në periudha, mendojmë se kemi arritur të pasqyrojmë pjesën kryesore të aktivitetit të SHKA„Sharri" dhe në këtë 40 vjetor, kemi arritur të vendosim një bazë të mirë të historikut të kësaj Shoqërie cili ishte edhe njëri ndër objektivat e mia.

Krahas të tjerave, kjo Shoqëri, me aktivitetin e saj 40 vjeçar, ka arritur që me plot sukses, kësaj treve t`u lë si trashëgimi etnomuzikologjie; këngë origjinale, valle e tablo koreografike të cilat do t`ju rezistojnë kohës që vjen. Ngjashëm me këtë, kjo Shoqëri ka nevojë që trevës sonë t`i sjellë këngë të tjera origjinale, valle me motiv nga pozita gjeografike dhe etnopsikologjik që kemi si dhe veshje sa më autoktone të trevës ku jetojmë.

Dhe në fund, falënderoj veteranët e Shoqërisë të cilët duke iu referuar kujtesës, ishin të palodhshëm në dhënien e shënimeve pa të cilat kjo monografi s`do të mund të shihte dritën e saj.

Shaban Çupi, maj 2014

Shënime për autorin

Pas botimit të librit *Trashëgimia kulturore në trevën e Hanit të Elezit*, me bashkautor në dhjetorin e vitit 2013, si dhe veprën tjetër *Jatakët e lirisë* përuruar në shkurtin e vitit 2014, autori Shaban Çupi, kësaj radhe solli edhe monografinë *Shoqëria Kulturore Artistike,,Sharri"* e cila botohet në 40 vjetorin e aktivitetit të kësaj Shoqërie, duke bërë përpjekje që ta plotësoj vakumin jo të vogël të trashëgimisë sonë kulturore në komunën e Hanit të Elezit.

Autori Shaban Çupi, krahas këtyre veprave, vite më parë, ka botuar edhe këto libra: *Gafurr Loku 1949-1999, Nga gjaku i tyre rrjedh liria, Shënime në kohë të mugëllt, Shkolla Populllore Shqiptare në fshatin Paldenicë* me bashkautor, *Historiku i xhamive dhe shkrimet mbivarrore në trevën e Hanit të Elezit* dhe në dorëshkrim ka edhe vepra të tjera nga fusha e etnologjisë.

Punon si mësimdhënës në fshatin Paldenicë dhe njëkohësisht është kryetar i Shoqatës së të Burgosurve Politik, dega në Han të Elezit.